

MANUAL PËR SIGURIMIN E CILËSISË SË TË DHËNAVE

SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS

SMP 2024

Përmbajtja

AKRONIMET	3
HYRJE	4
1. SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE PUBLIKE QË OFROJNË NJVV-TË	4
2. PARIMET THEMELORE	5
3. FAZAT PËR REALIZIMIN E SMP GJATË 2025	6
4. ELEMENTËT E PASAPORTËS SË TREGUESVE TË PERFORMANCËS.....	9
5. PASAPORTA E TREGUESVE TË PERFORMANCËS.....	10
KATEGORIA: SHËRBIME.....	10
FUSHA: ARSIMI PARAUNIVERSITAR.....	10
FUSHA: MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT	18
FUSHA: PYJET DHE KULLOTAT	21
FUSHA: MBROJTJA NGA ZJARRI.....	25
FUSHA: MENAXHIMI I MBETJEVE	26
FUSHA: MBROJTJA SOCIALE	31
KATEGORIA: MIRËQEVERISJA.....	41
FUSHA: BURIMET NJERËZORE	41
FUSHA: TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA	44
FUSHA: BARAZIA GJINORE	48
FUSHA: INTEGRIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN	52
KATEGORIA: MENAXHIMI FINANCIAR	58
FUSHA: TË ARDHURAT	58
FUSHA: BUXHETI.....	59
FUSHA: SHPENZIME	59
Shtojca 1: Lista e miratuar e treguesve të Sistemit të Matjes së Performancës 2025 nga Grupi Ndërinstitucional i Punës.....	61

AKRONIMET

AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
ALFIS	Albanian Forest & Information System
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BGJ	Barazia Gjinore
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
IDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe të Dhënave Personale
INSTAT	Instituti i Statistikave
KB	Këshilli Bashkiak
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MF	Ministria e Financave
MIM	Menaxhimi i Mbetjeve
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHPV	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor
MTM	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit
MZSH	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
NE	Ndihmë Ekonomike
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
PAK	Person me Aftësi të Kufizuar
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
SMP	Sistemi i Matjes së Performancës
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

HYRJE

Metodologjia për sigurimin e cilësisë së të dhënave përbën një dokument orientues për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV), duke i ndihmuar ato të mbledhin dhe raportojnë të dhëna të sakta dhe të qëndrueshme për treguesit e përfshirë në Sistemin e Matjes së Performancës (SMP).

Në mbështetje të Ligjit nr.17/2018 “Për statistikën zyrtare”, prodhimi i të dhënave përfshin të gjitha veprimtaritë e nevojshme për përgatitjen, mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, analizën dhe shpërndarjen e tyre.

Qëllimi i kësaj metodologjie është të sigurojë një përshkrim të qartë dhe të plotë për çdo të dhënë brenda SMP-së, duke garantuar cilësinë, gjurmueshmërinë dhe verifikueshmërinë e saj. Për secilin tregues përcaktohen metodat e përlogaritjes, burimi, niveli i disagregimit dhe procedurat e verifikimit, me qëllim prodhimin e të dhënave të sakta, të unifikuara dhe të besueshme.

Ofrimi cilësor dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve duhet të mbështeten në analiza të besueshme të të dhënave të mbledhura sipas standardeve të cilësisë. Në këtë kontekst, kjo metodologji luan një rol kyç, pasi përcakton:

- **Parimet themelore** që udhëheqin raportimin e të dhënave në kuadër të SMP-së;
- **Elementët përbërës** të pasaportës së të dhënave dhe mënyrën e plotësimit të saj;
- **Përshkrime të detajuara** për secilën të dhënë të raportuar.

Ky dokument, mund të jetë subjekt përmirësimi i vazhdueshëm si rrjedhojë e shtimit të të dhënave dhe treguesve që do të përfshihen në SMP, apo si pasojë e përmirësimit të proceseve të përdorura për përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe mënyrën e matjes e raportimit të treguesve.

Ky manual për Sistemin e Matjes së Performancës së Bashkive është hartuar nga AMVV dhe nëpërmjet mbështetjes teknike të projektit “Bashki të Forta”.

1. SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE PUBLIKE QË OFROJNË NJVV-TË

Menaxhimi i performancës bashkiake luan një rol kritik në ofrimin e shërbimeve efikase, llogaridhënien dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Me synimin për të avancuar performancën e vetëqeverisjes vendore, Qeveria Shqiptare është angazhuar në zhvillimin e Sistemit të Matjes të Performancës për NJVV-të, në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030¹.

Sistemi i Matjes së Performancës synon të promovojë një kulturë përmirësimi të vazhdueshëm, vendimmarrjeje të bazuar në të dhëna, transparencë dhe llogaridhënie, në funksion të rritjes së cilësisë dhe efektivitetit institucional të qeverisjes vendore. I ndërtuar në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare dhe vendore, sistemi orienton bashkitë drejt rezultateve të qarta dhe të matshme. Ai mbështet zbatimin e funksioneve bashkiake në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe shërben si mjet reflektimi, si brenda

¹ <https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/Vendim-i-KM-nr.-252-date-20.4.2023.pdf>

secilës bashki ashtu edhe përmes krahasimeve ndërmjet tyre. Gjithashtu, sistemi ndihmon në identifikimin e fushave ku nevojitet ndërhyrje apo mbështetje për rritje të mëtejshme të performancës.

Sistemi i Matjes së Performancës bazohet në parimet e mëposhtme:

- Rëndësia për bashkitë, komunitetet vendore, qeverinë qendrore dhe partnerët e zhvillimit;
- Arritja e rezultateve nga bashkitë në përputhje me kompetencat dhe nivelin e përpjekjeve të tyre;
- Rëndësia financiare;
- Besueshmëria e të dhënave dhe proceseve;
- Mbështetja të puna dhe përvojat e mëparshme;
- Krahasueshmëria ndërmjet bashkive;
- Zhvillimi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës.

Konkretisht, SMP synon përforsimin e ndërsjelltë të objektivave:

- **Stimulimi dhe promovimi i performancës së mirë bashkiake;**
- **Përmirësimi i efikasitetit të proceseve dhe burimeve;**
- **Shfrytëzimi i përvojës dhe informacionit për përmirësim të vazhdueshëm;**
- **Përmirësimi i planifikimit dhe vendimmarrjes.**

Sistemi i Matjes së Performancës është i strukturuar në tre kategoritë e mëposhtme:

- Shërbimet
- Mirëqeverisja
- Menaxhimi Financiar

Këto kategori janë zbrëthyer në 13 fusha prioritare me 52 tregues të performancës që vlerësojnë ushtrimin e kompetencave bashkiake.

Në secilën fushë, bashkitë përcaktojnë rezultate specifike që reflektojnë nevojat dhe prioritetet e tyre, të matura përmes treguesve cilësorë dhe sasiorë. Të dhënat mbështesin treguesit dhe sigurojnë një bazë të fortë për vlerësimin e performancës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe menaxhimit.

2. PARIMET THEMELORE

Për të siguruar cilësinë e të dhënave dhe besueshmërinë e tyre për qytetarët dhe shërbimet publike, prodhuesit e të dhënave duhet të ndjekin këto parime themelore:

- **Pavarësia profesionale:** Të dhënat duhet të përgatiten në mënyrë të pavarur, duke zgjedhur vetë teknikat, përkufizimet, metodologjitë dhe burimet, pa ndikim nga grupe politike, interesa të veçanta apo autoritete shtetërore.
- **Paanshmëria:** Të dhënat duhet të përgatiten në mënyrë të paanshme dhe neutrale, pa favorizuar asnjë palë apo interes.
- **Objektiviteti:** Të dhënat duhet të mblidhen dhe përpunohen në mënyrë të sistematizuar, të besueshme dhe paanshme.
- **Besueshmëria:** Të dhënat duhet të maten në mënyrë të saktë, të qëndrueshme dhe të besueshme, duke përdorur metoda dhe burime shkencore që reflektojnë realitetin që përfaqësojnë.

- **Konfidencialiteti:** Mbrojtja e të dhënave që mund të zbulojnë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, informacion individual të papublikuar për arsye të sigurimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
- **Raporti kosto-efektivitet:** Kostot e mbledhjes së të dhënave duhet të jenë të arsyeshme në lidhje me përfitimet e pritshme. Burimet duhet të përdoren në mënyrë efikase, duke minimizuar barrën për të dhënë informacion. Informacioni i nevojshëm, sa herë që është e mundur, duhet të sigurohet nga të dhënat ose burimet ekzistuese.

3. FAZAT PËR REALIZIMIN E SMP GJATË 2025

SMP e realizuar gjatë vitit 2025 përbën ciklin e tij të dytë. Realizimi i SMP në vitin 2024, kulmoi me publikimin e Raportit Kombëtar të Performancës të Bashkive, në Nëntor 2024. Gjatë periudhës Janar-Qershor, AMVV i'u dedikua një faze përgatitore gjatë të cilës u mor në verifikim procesi, treguesit dhe të dhënat e vitit 2023, për të nxjerre në pah dhe adresuar problematika të ndryshme. Vlerësimi i kryer shërbeu si bazë e tryezave teknike për cdo fushë, gjatë të cilave u diskutua dhe ra dakort për përmirësime të listës së treguesve, të dhënave si dhe aspekte të procesit. Kjo fazë e parë përgatitore rezultoi në një listë të re të zgjeruar dhe përmirësuar si dhe instrumenta e proces të përmirësuar për SMP 2025.

Gjatë kësaj faze u zhvilluan një sërë materialesh metodologjike, si lista e tregueve, dizenjimi i pyetësorit, zhvillimi i programit mbledhjes së të dhënave në google form, hartimi manualit, planifikimi i trajnimeve me trajnerët dhe stafet e Njësisë të Performancës së Bashkive, përgatitja e materialeve të trajnimit, të gjitha këto bëjnë të mundur realizimin me sukses të SMP 2025.

Faza II, ajo e grumbullimit të të dhënave dhe raportimit të performancës së bashkive fillon me një kërkesë zyrtare të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), e cila u drejtohet të gjitha Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore. Në këtë kërkesë përcaktohen treguesit e performancës që duhet të raportohen, formati përkatës i raportimit si dhe afatet kohore për dorëzimin e të dhënave.

Me pranimin e kërkesës nga AMVV, Kryetari i Bashkisë miraton fillimin e procesit të mbledhjes së të dhënave përmes një urdhri të brendshëm për raportimin e vitit përkatës.

Në zbatim të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, Koordinatori i Performancës (KP) i caktuar organizon takim shpjegues dhe inicion procesin përkatës me të gjitha njësitë teknike të bashkisë për mbledhjen e të dhënave për raportimin e performancës së bashkive. Në varësi të mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në dispozicion të bashkisë, mbledhja e të dhënave mund të shpërndahet në mënyrë elektronike ose në format fizik nëpërmjet një pyetësori.

KP referuar afateve të përcaktuara, mbledh informacionin e plotësuar dhe të nënshkruar nga drejtuesit e njësive përkatëse të bashkisë. Ai kryen kontrollin e plotësisë së të dhënave dhe verifikimin e cilësisë së tyre në varësi të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësitë përkatëse. Gjatë këtij procesi, KP ndërvepron me njësitë përkatëse dhe ekspertët e shërbimit, sipas nevojës, për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave. KP regjistron të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit të mbledhjes së të dhënave të performancës së bashkisë.

Koordinatori i Performances përgatit materialin përfundimtar të kërkuar për raportim nga AMVV, sipas formatit të përcaktuar në kërkesë, dhe ia dërgon Kryetarit të Bashkisë për miratim. Materiali i miratuar dërgohet tek AMVV brenda afatit të përcaktuar.

Nëpërmjet pyetësorit të mbledhjes së të dhënave të performancës, të gjithë treguesit përlllogariten sipas formulave të përcaktuara në pasaportë gjatë fazës së përpunimit të të dhënave nga AMVV.

Ky proces mbështetet në disa mjete elektronike që standardizojnë dhe lehtësojnë mbledhjen e të dhënave, përlogaritjen e treguesve të performancës dhe raportimin e tyre sipas standardit të përcaktuar nga AMVV. Këto mjete përfshijnë:

- Formatet standarde të raportimit të treguesve të SMP-së sipas kërkesës së AMVV (lista e treguesve dhe të dhënat e miratuara nga AMVV).

AMVV vë në dispozicion të bashkive staf të dedikuar për të mbështetur procesin e raportimit të performancës. Ky staf është përgjegjës për të komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me bashkitë, me qëllim qartësimin e procedurave të grumbullimit të të dhënave, si dhe për të siguruar raportimin e tyre në mënyrë të saktë dhe brenda afateve.

Raporti Kombëtar i Performancës së Bashkive hartohet nga AMVV, bazuar në të dhënat e raportuara zyrtarisht. Të gjitha të dhënat e raportuara duhet të jenë të nënshkruara nga kryetari i bashkisë, si dëshmi e vërtetësisë dhe përgjegjësisë institucionale. AMVV mund të korrigjojë çdo informacion të pasaktë nga verifikimi dhe analiza e të dhënave, duke u bazuar nga të dhënat zyrtare të raportuara nga institucionet qendrore. Mbas verifikimit, pastrimit dhe analizimit të të dhënave nga AMVV, gjate fazës së tretë, procesi përmbyllet me publikim e Raportit të Performancës 2025.

Në mënyrë të përmbledhur i gjithë procesi i SMP 2025, Njësitë përgjegjëse dhe materialet e prodhuar jepen në skemën e mëposhtme:

Hapi	Përgjegjës	Aktiviteti	Afati
Faza I: Përgatitore			
I.	AMVV	Rishikim i procesit të SMP 2024 dhe sfidave në grumbullimin e të dhënave. Evidentimi i problematikave në proces, treguesve apo të dhënave me probleme	15.01.2025-31.03.2025
II.	AMVV	Zhvillimi i tryezave konsultuese me Ministri të Linjës, dhe ekspertë të nivelit vendor për rishikimin e procesit, dokumentacionit shoqërues, treguesve të dhënave. Përmirësimi dhe zgjerimi i listës së SMP 2024 dhe instrumentave	5-10.04.2025
III.	AMVV	Miratimi i listës së përmirësuar të SMP 2025 nga Grupi Ndërinstitucional i Punës.	17.06.2025
IV.	AMVV	Përgatitja e materialeve të metodologjisë dhe procesit të mbledhjes të të dhënave për SMP 2025 (pyetëtori, manuali, prezantime, listë treguesish, programi i mbledhjes së të dhënave-google form, strategjia e trajnimeve etj.)	15.01.2025-04.07.2025
V.	AMVV	Organizon trajnime mbi procesin e matjen së performancës së bashkive	07- 08.07.2025
Faza II: Mbledhja e të dhënave të SMP			

I.	AMVV	Dërgon kërkesën për raportimin vjetor tek të gjitha bashkitë. Kjo kërkesë përmban qëllimin, listen e treguesve të performancës me të dhënat përkatëse të kërkuara, afatet kur bashkitë duhet të dërgojnë raportimin me të dhënat e tyre, si dhe udhëzimet për përgatitjen e tij.	10.07.2025
II.	Kryetari i Bashkisë	Miraton urdhrin e brendshëm për raportimin vjetor kombëtar të performancës së bashkisë në kuadër të kërkesës së AMVV.	10.07.2025
III.	Koordinatori Performancës	Dërgon zyrtarisht pyetësozin tek njësitë teknike në bashki për plotësim.	09.07.2025
IV.	Njësitë Teknike dhe KP - Departamentet - Drejtoritë - Sektorët përgjegjës	Mbledhin të dhënat e performancës dhe plotësojnë këto të dhëna në formatin e raportimit. Dërgojnë në formë zyrtare të dhënat e plotësuara sipas fushave përkatëse dhe të firmosura tek Koordinatori Performancës.	10-25.07.2025
V.	KP	Mbledh dhe verifikon plotësimin e të dhënave të performancës: Verifikon, sipas mundësive, saktësinë e të dhënave të raportuara, duke përdorur pasaportën e të dhënave. Ndërvepron me njësitë teknike për korrigjimin e mangësive dhe përmirësimin e saktësisë së të dhënave, sipas nevojës.	26-28.07.2025
VI.	KP	Regjistron të dhënat në mekanizmin e raportimit të performancës: Përgatit materialin përfundimtar për raportim tek AMVV, në formatin e kërkuar (shkresë zyrtare dhe materiali i printuar); Dërgon materialin përfundimtar tek Kryetari i Bashkisë për miratim / raportim për performancën e bashkisë në nivel kombëtar të AMVV.	28-30.07.2025
VII.	Kryetari i Bashkisë	Miraton dhe dërgon Raportin e Performancës së Bashkisë për raportimin kombëtar tek AMVV (si dhe dërgimi elektronik i Google Form të plotësuar).	31.07.2025
Faza III: Analizë dhe Publikim			
I.	AMVV	Grumbullon të dhënat e treguesve të performancës për çdo bashki. Verifikon dhe kontrollon plotësinë e të dhënave. Përpunon dhe analizon të dhënat për ti validuar.	01.08.2025– 30.09.2025

		Përlllogarit treguesit dhe analizon gjetjet e raportit kombëtar të performancës së bashkive.	
II.	AMVV	Prezanton gjetjet e raportit kombëtar të performancës së bashkive në mbledhjen e Këshillit Konsultativ. Publikon raportin kombëtar të performancës së bashkive dhe e prezanton në një konferencë kombëtare.	01.10.2025– 21.11.2025

Lidhja e procesit të SMP 2025 me Grantin e Bazuar në Performancë (GBP). Granti i Bazuar në Performancë (GBP) përbën një instrument financiar incentivues me fonde të përbashkëta nga buxheti i shtetit dhe donatorëve që shpërndan fonde shtesë për bashkitë, bazuar në vlerësimin e performancës së tyre në fusha të përzgjedhura. Treguesit e performancës të përcaktuar në Manualin e SMP-së shërbejnë si burimi kryesor i të dhënave për vlerësimin e kritereve të grantit. Mbushja dhe dorëzimi i të gjithë të dhënave të treguesve të SMP 2025, për vitin e raportimit 2024 brenda afateve të caktuara, është në vetvete një nga 10 kriteret e cilësuar nga Udhëzimi, që lidhen me përfitimin nga transfertat financiare për bashkitë nga Granti i Bazuar në Performancë për vitin 2025.

4. ELEMENTËT E PASAPORTËS SË TREGUESVE TË PERFORMANCËS

Bazuar në Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, të dhënat për raportim dhe analiza duhet të shoqërohen me metadatat përkatëse. Metadatat përfshijnë informacion të standardizuar mbi burimin, metodologjinë, përkufizimet, klasifikimet dhe cilësinë e të dhënave. Për këtë arsye, çdo e dhënë shoqërohet nga pasaporta e të dhënës, ku plotësohen të gjithë elementët përkatës. Më poshtë përshkruhen elementët, kuptimi dhe mënyra e plotësimit të pasaportës së të dhënës.

Në këtë seksion detajohen elementët e skedës për të gjithë treguesit e performancës që do të raportohen në SMP sipas fushave.

Skedat e treguesve dhe të dhënave përmbajnë:

Kodi i treguesit: Është kodi unik identifikues i treguesit.

Emri i treguesit: Duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe të përcaktojë në mënyrë unike treguesin.

Rezultati: Niveli i synuar i shërbimit është standardi që bashkia synon të arrijë për të gjeneruar rezultate për qytetarët dhe administratën. Matet përmes treguesit përkatës të performancës.

Disagregimi: Përcakton nivelin e disagregimit të të dhënës sipas: gjinisë, moshës dhe ndarjes gjeografike (rurale/urbane).

Kodi i të dhënës: Kodi unik identifikues i të dhënës.

Emri i të dhënës: Duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe të përcaktojë saktësisht dhe në mënyrë unike të dhënë.

Njësia matëse: Përcakton njësinë që përdoret për të matur të dhënën. Për të dhëna të ngjashme duhet të përdoret e njëjta njësi matëse.

Burimi i të dhënës: Përcaktohet njësia përgjegjëse brenda bashkisë për prodhimin e të dhënës. Në rast se e dhëna merret nga një institucion tjetër, si burim konsiderohet njësia brenda bashkisë që e merr të dhënën nga institucioni përkatës.

Metoda e mbledhjes së të dhënës: Përcakton metodën e përdorur për të matur dhe mbledhur të dhënën.

Metoda e verifikimit të të dhënës: Përcakton metodën e përdorur për të verifikuar saktësinë e të dhënës.

Institucioni përgjegjës për verifikimin e të dhënës: Në rastet kur ligji cakton institucione përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave nga institucione të tjera publike ose private, këto institucione përfaqësojnë subjektin përgjegjës për verifikimin e të dhënës përkatëse.

Formula: Përcakton mënyrën sesi llogaritet treguesi i performancës.

5. PASAPORTA E TREGUESVE TË PERFORMANCËS

Lista e treguesve është miratuar nga Grupi Ndërinstitucional i Punës i krijuar me Urdhër të Kryeministrit nr.213 datë 13.12.2023 “Për disa ndryshime dhe një shtesë në Urdhërin nr.17 datë 20.02.2023 të Kryeministrit “Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e propozimeve ligjore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet sistemit të matjes së performancës””.

KATEGORIA: SHËRBIME

FUSHA: ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas *Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*. Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- **Funksioni 23.11:** “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.”
- **Funksioni 23.12:** “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.”

Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre. Kjo përfshin ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore (23.11), si dhe administrimin e plotë të sistemit parashkollor (kopshte dhe çerdhe) përmes funksionit 23.12, që përfshin menaxhimin e stafit ndihmës, mbështetjen logjistike dhe rregullimin funksional të shërbimit.

Pasaporta përfshin një seri treguesish që monitorojnë jo vetëm pjesëmarrjen e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte, por edhe cilësinë e infrastrukturës, raportet edukator-fëmijë, dhe ekzistencën e planeve strategjike

për zhvillimin e sektorit. Kjo i mundëson bashkive të planifikojnë më mirë ndërhyrjet dhe të përmirësojnë shërbimet sipas standardeve kombëtare.

TREGUESI A01 - SHKALLA E REGJISTRIMIT NË ÇERDHE

Rezultati i synuar: Rritja e aksesit në arsimin e hershëm dhe parashkollor.

Ky tregues mat nivelin e pjesëmarrjes së fëmijëve të grupmoshës nga 6 muaj deri në 3 vjeç në çerdhet publike të menaxhuara nga bashkia. Ai shërben për të vlerësuar kapacitetin e bashkisë për të ofruar shërbime arsimore të hershme dhe për të monitoruar përfshirjen e hershme të fëmijëve në sisteme edukative.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregim: Gjinor dhe grupmoshë

Formula : $A01 = (A01.2 / A01.1) * 100$

Për të gjeneruar këtë tregues mbledhen të dhënat më poshtë:

- **A01.1** Numri i fëmijëve të grupmoshës nga 6 muaj-3 vjeç në bashki
- **A01.2** Numri i fëmijëve të grupmoshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike

A01.1 NUMRI I FËMIJËVE TË GRUPMOSHËS NGA 6 MUAJ-3 VJEÇ NË BASHKI

Përshkrimi i të dhënës : Përfaqëson numrin total të fëmijëve të grupmoshës nga 6 muaj deri në 3 vjeç që jetojnë në territorin e bashkisë, si bazë për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të hershme për fëmijët.

Disagregimi: Gjinor dhe grupmoshë

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë

Metoda e mbledhjes: A01.1 sigurohet nga Instituti i Statistikave nëpërmjet AMVV-së

Metoda e verifikimit: Instituti i Statistikave nëpërmjet AMVV

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV

A01.2 NUMRI I FËMIJËVE TË GRUPMOSHËS 6 MUAJ DERI NË 3 VJEÇ TË REGJISTRUAR NË ÇERDHE PUBLIKE

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson numrin e fëmijëve të grupmoshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike në territorin e bashkisë.

Disagregimi: Gjinor dhe grupmoshë

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Raportim vjetor nga drejtorët e çerdheve. Njësia përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të çerdhes në bashki agregon informacionin.

Metoda e verifikimit: Regjistrat fizikë të çerdheve dhe regjistrat e vaksinimit.

Kujdes: Regjistri kombëtar i vaksinimit mund të mos jetë burimi më i saktë për të gjeneruar të dhënën pasi ka disa bashki (sidomos ato me pakica minoritare), ku fëmijët i realizojnë vaksinat në shtetet fqinje.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

TREGUESI A02 - SHKALLA E REGJISTRIMIT NË KOPSHTET PUBLIKE DHE PRIVATE

Rezultati i synuar: Rritja e aksesit në arsimin e hershëm dhe parashkollor

Ky tregues reflekton përfshirjen e fëmijëve të grupmoshës 3–6 vjeç në institucionet e arsimit parashkollor, duke ndarë pjesëmarrjen në sektorin publik dhe atë privat. Ai tregon kapacitetin e bashkive për të ofruar dhe monitoruar shërbimet arsimore për fëmijët para fillimit të arsimit të detyrueshëm.

Treguesi mat përqindjen e fëmijëve në moshë kopshti në territorin e bashkisë që frekuentojnë kopshtin.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregim: Publik, privat

Formula: $A02 = (A02.2 + A02.3) / A02.1 * 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **A02.1** Numri i fëmijëve të grupmoshës nga 3–6 vjeç në bashki
- **A02.2** Numri i fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç të regjistruar në kopshtet publike
- **A02.3** Numri i fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç të regjistruar në kopshtet private

A02.1 NUMRI I FËMIJËVE TË GRUPMOSHËS NGA 3–6 VJEÇ NË BASHKI

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson numrin total të fëmijëve të grupmoshës nga 3 deri në 6 vjeç që jetojnë në territorin e bashkisë, si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e shërbimeve parashkollore dhe mbulimit me edukim të hershëm.

Disagregimi: Gjinnor dhe grupmoshë

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë

Metoda e mbledhjes: Numri gjithsej i fëmijëve 3–6 vjeç sigurohet nga INSTAT ndërmjet AMVV-së.

Metoda e verifikimit: Regjistrat e INSTAT

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) / AMVV / Njësia e Performancës.

A02.2 NUMRI I FËMIJËVE TË GRUPMOSHËS 3-6 VJEÇ TË REGJISTRUAR NË KOPSHTET PUBLIKE

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson numrin e fëmijëve të grupmoshës 3 deri në 6 vjeç të regjistruar në kopshte publike në territorin e bashkisë, si tregues i përfshirjes së hershme në sistemin arsimor parashkollor.

Disagregimi: Gjinor dhe grupmoshë

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Regjistrimi i fëmijëve kryhet nga drejtuesi i kopshtit dhe dosjet e fëmijëve ruhen në kopsht. Mbledhja e të dhënës bëhet nëpërmjet raportimit vjetor të drejtorëve të kopshteve publike mbi numrin e fëmijëve të regjistruar.

Metoda e verifikimit: Regjistrat e kopshteve

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Drejtoria përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki / Njësia e Performancës, AMVV/ MAS.

A02.3 NUMRI I FËMIJËVE TË GRUPMOSHËS 3-6 VJEÇ TË REGJISTRUAR NË KOPSHTET PRIVATE

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson numrin e fëmijëve të grupmoshës 3 deri në 6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private në territorin e bashkisë, si tregues i përfshirjes në arsimin parashkollor jashtë rrjetit publik dhe i zgjedhjeve të familjeve për ofrues alternativë të shërbimit.

Disagregimi: Gjinor dhe grupmoshë

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Mbledhja e të dhënës bëhet nëpërmjet komunikimit me Drejtorinë Arsimore Rajonale. E dhëna kërkohet e disagreguar sipas gjinisë dhe grupmoshës.

Metoda e verifikimit: Komunikim zyrtar me Drejtorinë Rajonale të Arsimit për kopshtet private.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: MAS / AMVV/ Njësia e performancës.

TREGUESI A03 - RAPORTI FËMIJË-MËSUES NË KOPSHTET PUBLIKE DHE PRIVATE

Rezultati i synuar: Përmirësimi i mësimdhënies në arsimin parashkollor.

Ky tregues mat numrin mesatar të fëmijëve për çdo edukator/e në kopshte, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Një raport i ulët fëmijë-mësues sugjeron më shumë cilësi në ofrimin e edukimit.

Njësia Matëse: Numër

Disagregim: Publik, privat

Formula:

$A03_1 = A02.1 / A03.1$ (për kopshtet publike)

$A03_2 = A02.2 / A03.2$ (për kopshtet private)

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **A02.2** Numri i fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç të regjistruar në kopshtet publike
- **A02.3** Numri i fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç të regjistruar në kopshtet private
- **A03.1** Numri i edukatorëve në kopshte publike
- **A03.2** Numri i edukatorëve në kopshte private

A03.1 NUMRI I EDUKATORËVE NË KOPSHTET PUBLIKE

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson numrin e edukatorëve që punojnë në kopshte publike në territorin e bashkisë, si tregues i kapaciteteve njerëzore të disponueshme për ofrimin e shërbimeve të edukimit parashkollor.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Raportim nga kopshtet, dokumentacion nga zyra e burimeve njerëzore.

Metoda e verifikimit: Kontroll i dosjeve të personelit dhe pagave.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia vendore përgjegjëse për shërbimin, Njësia e Performancës.

A03.2 NUMRI I EDUKATORËVE NË KOPSHTET PRIVATE

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson numrin e edukatorëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në kopshte private brenda territorit të bashkisë, si tregues i kapaciteteve të burimeve njerëzore në sektorin jopublik të arsimit parashkollor.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Të dhëna nga drejtoritë rajonale arsimore për numrin e edukatorëve në kopshtet private.

Metoda e verifikimit: Komunikim zyrtar me Drejtoritë Rajonale të Arsimit (DAR)

Institucioni përgjegjës për verifikimin: MAS, Njësia vendore përgjegjëse për shërbimin, Njësia e Performancës.

TREGUESI A04 - NUMRI I GODINAVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE SIPAS NIVELIT ARSIMOR

Rezultati i synuar: Përmirësimi i infrastrukturës në institucionet arsimore

Treguesi mat numrin e godinave të përdorura për shërbime arsimore në nivelet e çerdheve, kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe shkollave të mesme të përgjithshme publike dhe private.

Në institucione private përfshihen:

- Çerdhe private – institucione përkujdesjeje për fëmijët 0-3 vjeç, të menaxhuara nga subjekte jopublike.
- Kopshte private – institucione edukimi për fëmijët 3-6 vjeç, që operojnë me licencë nga MAS ose pushteti vendor, por që nuk janë të financuara nga buxheti i shtetit.
- Shkolla private 9-vjeçare (arsimi bazë) – institucione që ofrojnë klasat I-IX, me kurrikulë të miratuar nga MAS, por të themeluara dhe të operuara nga subjekte private.
- Shkolla të mesme të përgjithshme private – ofrojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm (klasat X-XII), sipas standardeve kombëtare, por me financim dhe menaxhim privat.

Kujdes: Një godinë që përdoret për më shumë se një shërbim do të llogaritet për secilin prej shërbimeve që ofron. **Shembull:** Nëse një institucion arsimor ofron parashkollor në godinën e kopshtit dhe arsim bazë në të njëjtën godinë apo një tjetër, të dyja shërbimet do të regjistrohen veçmas.

Njësia Matëse: Numër

Disagregimi: Publik, privat.

Formula: $A04 = A04.1 + A04.2 + A04.3 + A04.4$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **A04.1** Numri i çerdheve në bashki
- **A04.2** Numri i kopshteve në bashki
- **A04.3** Numri i shkollave 9-vjeçare në bashki
- **A04.4** Numri i shkollave të mesme të përgjithshme në bashki

A04.1 NUMRI I ÇERDHEVE NË BASHKI

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson numrin total të çerdheve publike dhe private që funksionojnë në territorin e bashkisë, si tregues i aksesit të komunitetit në shërbimet e kujdesit për fëmijët e moshës 0–3 vjeç.

Disagregimi: Publik, privat.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Kontroll i dokumentacionit të aseteve dhe kontratave për institucionet publike dhe komunikim zyrtar me drejtorinë rajonale të arsimit për institucionet private.

Metoda e verifikimit: Verifikim në sektorin e menaxhimit të aseteve në bashki për institucionet publike dhe komunikimin zyrtar me DAR për institucionet private.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), MAS, AMVV, Njësia e Performancës.

A04.2 NUMRI I KOPSHTEVE NË BASHKI

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson numrin total të kopshteve publike dhe private që veprojnë në territorin e bashkisë, si tregues i kapacitetit lokal për ofrimin e edukimit parashkollor për fëmijët e moshës 3–6 vjeç.

Disagregimi: Publik, privat.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Kontroll i dokumentacionit të aseteve dhe kontratave për institucionet publike dhe komunikim zyrtar me drejtorinë rajonale të arsimit për institucionet private.

Metoda e verifikimit: Verifikim në sektorin e menaxhimit të aseteve në bashki për institucionet publike dhe komunikimin zyrtar me DAR për institucionet private.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: ZRPP, MAS, AMVV, Njësia e Performancës.

A04.3 NUMRI I SHKOLLAVE 9-VJEÇARE NË BASHKI

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson numrin total të shkollave 9-vjeçare publike dhe private në territorin e bashkisë, si tregues i shpërndarjes së infrastrukturës bazë arsimore në arsimin fillor.

Disagregimi: Publik, privat.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Kontroll i dokumentacionit të aseteve dhe kontratave për institucionet publike dhe komunikim zyrtar me drejtorinë rajonale të arsimit për institucionet private.

Metoda e verifikimit: Verifikim në sektorin e menaxhimit të aseteve në bashki për institucionet publike dhe komunikimin zyrtar me DAR-Drejtorinë rajonale të arsimit për institucionet private.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: ZRPP, MAS, AMVV, Njësia e Performancës.

A04.4 NUMRI I SHKOLLAVE TË MESME TË PËRGJITHSHME NË BASHKI

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson numrin total të shkollave të mesme të përgjithshme publike dhe private në territorin e bashkisë, si tregues i aksesit të të rinjve në arsim të mesëm.

Disagregimi: Publik, privat.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Kontroll i dokumentacionit të aseteve dhe kontratave për institucionet publike dhe komunikim zyrtar me drejtorinë rajonale të arsimit për institucionet private.

Metoda e verifikimit: Verifikim në sektorin e menaxhimit të aseteve në bashki për institucionet publike dhe komunikimin zyrtar me DAR për institucionet private.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: ZRPP, MAS, AMVV, Njësia e Performancës.

TREGUESI A05 - PLAN VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rezultati i synuar: Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parauniversitar

Ky tregues reflekton nivelin e planifikimit strategjik të arsimit në nivel vendor dhe monitoron ekzistencën, miratimin dhe zbatimin e planit.

Njësia Matëse: Cilësore (Plan i miratuar në vitin e raportimit/Plan në zbatim (miratuar më herët)/Nuk ka plan).

Disagregimi: Nuk ka

Formula: Nëse: (Vendimi i Këshillit Bashkiak ekziston dhe është publikuar në faqen zyrtare, ekziston procesverbali i mbledhjes së miratimit dhe konfirmimi nga Institucioni i Prefektit) → A05 = “Plan i miratuar në vitin e raportimit”. Ndryshe nëse: (Dokumentet e zbatimit si plani i masave, raporti i zbatimit dhe buxheti janë të disponueshme) → A05 = “Plan në zbatim (miratuar më herët)”. Përndryshe: → A05 = “Nuk ka plan”.

Përfshirja në GBP: Ky tregues është pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë.

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **A05.1 Plani i Arsimit Parauniversitar i miratuar**
- **A05.2 Periudha e miratimit të Planit të Arsimit Parauniversitar**
- **A05.3 Periudha e vlefshmërisë së Planit të Arsimit Parauniversitar**

A05.1 PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR I MIRATUAR

Përshkrimi i të dhënës: E dhëna pasqyron nëse bashkia ka hartuar dhe miratuar një Plan të Arsimit Parauniversitar.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo).

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin në bashki.

Metoda e mbledhjes: Nëse Plani i Arsimit Parauniversitar është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak brenda datës së raportimit, është publikuar në faqe të internetit të bashkisë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit dhe ka procesverbal të mbledhjes së Këshillit Bashkiak në të cilën është miratuar vendimi, konsiderohet “Po” dhe në të kundërt “Jo”.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, link-u i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse, vendimi i Institucionit të Prefektit që konfirmon VKB, procesverbali i nënshkruar nga tre anëtarë të Këshillit Bashkiak me rezultatet e votimit për vendimin.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

A05.2 PERIUDHA E MIRATIMIT TË PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton periudhën e miratimit të Planit të Arsimit Parauniversitar i cili mund të jetë para vitit të raportimit, gjatë vitit të raportimit ose përgjatë vitit 2025.

Njësia Matëse: Muaj/vit

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimet arsimore në bashki.

Metoda e mbledhjes: Kontroll dokumentacioni dhe statusi i planit.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, linku i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi. Buxhet dhe plan zbatimi nëse plani është aprovuar përpara vitit të raportimit. Konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës

A05.3 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton periudhën e vlefshmërisë së Planit të Arsimit Parauniversitar i cili mund të jetë disa vjeçar.

Njësia Matëse: Numër (muaj nga muaji i raportimit)

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Kontroll dokumentacioni dhe statusi i zbatimit të planit.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë brenda periudhës së raportimit, linku e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi. Buxhet dhe plan zbatimi nëse plani është aprovuar përpara vitit të raportimit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV.

FUSHA: MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i përgjithshëm: Funkcioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 23 pika 1. Në mbështetje të tij VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015 transferon infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit në pronësi të bashkive². Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse.

Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimit të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

²<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6813&token=835cb643657fb7acdb5f6431515ac9fbfe91d287>

Pasaporta përfshin dy tregues kryesorë që matin përmasën e rrjeteve funksionale dhe mbulimin e sipërfaqes bujqësore nga sistemet e ujitjes dhe kullimit, duke mundësuar një vlerësim të qartë të situatës aktuale dhe një bazë të mirë për planifikimin e ndërhyrjeve.

TREGUESI B01 - TOKË BUJQËSORE E PAJISUR ME KANALE UJITJE / KULLIMI

Rezultati i synuar: Përmirësimi i aksesit në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit.

Ky tregues mat sipërfaqen e tokës bujqësore të mbuluar me sisteme funksionale të ujitjes dhe kullimit.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregimi: Nuk ka

Formula: $B01 = (B01.2 / B01.1) * 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **B01.1** Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki
- **B01.2** Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi

B01.1 SIPËRFAQJA GJITHSEJ E TOKËS BUJQËSORE NË BASHKI

Përshkrimi i të dhënës: Përfaqëson gjithë tokën e dedikuar për qëllime bujqësore në territorin e bashkisë, si bazë për vlerësimin e mbulimit me infrastrukturë ujitjeje dhe kullimi

Njësia Matëse: Hektarë (ha), km²

Burimi: Njësia përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Regjistrat e njësisë përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes sipas organikës së bashkisë.

Metoda e verifikimit: Verifikim në regjistrat e njësisë përgjegjëse dhe PPV.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

B01.2 SIPËRFAQJA E TOKËS BUJQËSORE E MBULUAR ME KANALE UJITJE DHE/OSE KULLIMI

Përshkrimi i të dhënës: Kjo e dhënë përfaqëson sipërfaqen bujqësore që mbulohet aktualisht nga rrjeti i ujitjes dhe kullimit i menaxhuar nga bashkia, i cili ndihmon në sigurimin e prodhimit bujqësor të qëndrueshëm.

Njësia Matëse: Hektarë (ha), km²

Burimi: Njësia përgjegjëse për bujqësinë sipas organikës së bashkisë

Metoda e mbledhjes: Mbështetur në regjistrat e njësisë përgjegjëse dhe raportet periodike të investimeve në kanale ujitjeje dhe kullimi.

Metoda e verifikimit: Kontroll i dokumentacionit teknik të kanaleve të ujitjes dhe kullimit (harta, skemat e rrjetit, raport inspektimi), procesverbale të mirëmbajtjes ose planifikimeve operative.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës

TREGUESI B02 - PËRQINDJA E KANALEVE FUNKSIONALE TË UJITJES DHE KULLIMIT

Rezultati i synuar: Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit ujitës dhe kullues

Ky tregues mat përqindjen e tokës bujqësore që mbulohet me infrastrukturë funksionale për ujitje dhe/ose kullim në territorin e bashkisë.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregimi: Ujitje, kullim

Formula:

$$B02_1 = (B02.2 / B02.1) \times 100$$

$$B02_2 = (B02.4 / B02.3) \times 100$$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **B02.1 Gjatësia e kanaleve ujitëse**
- **B02.2 Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale**
- **B02.3 Gjatësia e kanaleve kulluese**
- **B02.4 Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale**

B02.1 GJATËSIA E KANALEVE UJITËSE

Përshkrimi i të dhënës: Kjo e dhënë tregon gjithë gjatësinë e rrjeteve të ujitjes që ndodhen në territorin e bashkisë, pavarësisht funksionalitetit të tyre.

Njësia Matëse: Kilometër (km), Metër (m)

Burimi: Njësia përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes sipas organikës së bashkisë

Metoda e mbledhjes: Nxirret nga inventari i infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja

Metoda e verifikimit: Verifikim në VKM dhe inventarët përkatës

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës

B02.2 GJATËSIA E KANALEVE UJITËSE FUNKSIONALE

Përshkrimi i të dhënës: Kjo e dhënë përfaqëson gjatësinë e kanaleve që aktualisht janë në gjendje funksionale për të kryer proceset e ujitjes.

Njësia Matëse: Kilometër (km), Metër (m)

Burimi: Njësia përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Raportimi vjetor nga sektorët përgjegjës për mirëmbajtjen dhe monitorimin e kanaleve verifikuar përmes regjistrave dhe inspektimeve.

Metoda e verifikimit: Tabela e plotësuar dhe firmosur nga njësia e shërbimit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës / MBZHR.

B02.3 GJATËSIA E KANALEVE KULLUESE

Përshkrimi i të dhënës: Tregon gjithë gjatësinë e rrjeteve të kullimit që ndodhen në territorin e bashkisë, pavarësisht funksionalitetit të tyre.

Njësia Matëse: Kilometër (km), Metër (m)

Burimi: Njësia përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së kullimit sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Nxirret nga inventari i infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja.

Metoda e verifikimit: Verifikim në VKM dhe inventarët përkatës

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës / MBZHR

B02.4 GJATËSIA E KANALEVE KULLUESE FUNKSIONALE

Përshkrimi i të dhënës: Kjo e dhënë përfaqëson gjatësinë e kanaleve që aktualisht janë në gjendje funksionale për të kryer proceset e kullimit.

Njësia Matëse: Kilometër (km), Metër (m)

Burimi: Njësia përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Raportim nga sektorët përgjegjës për mirëmbajtjen dhe monitorimin e kanaleve verifikuar përmes regjistrave dhe inspektimeve.

Metoda e verifikimit: Tabela e plotësuar dhe firmosur nga njësia e shërbimit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

FUSHA: PYJET DHE KULLOTAT

Përshkrim i përgjithshëm : Funksioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i është deleguar bashkive me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullësor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Në mbështetje të tij VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 transferon fondin pyjor dhe kullësor në pronësi të bashkive³.

Bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin

³<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=5106&token=176402909cdf2b5ce63d0c1aa1e995d8c98ee256>

për pyjet dhe kullotat. Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” VKM nr. 710, datë 5.10.2022 “Për regjistrin pyjor dhe kullosor”, sanksionon detyrimet e bashkive në këtë drejtim.

Të dy treguesit ndihmojnë në matjen e kapacitetit të bashkisë për të garantuar menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave dhe për të drejtuar investimet drejt zonave që kanë nevojë për mbështetje.

TREGUESI P01 - SHKALLA E PAJISJES ME PLANE MBARËSHTIMI

Rezultati i synuar : Rritja e menaxhimit të qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor

Ky tregues mat përmasën e fondit pyjor dhe kullosor të mbuluar me plane mbarështimi dhe statusin e zbatimit të tyre, duke reflektuar nivelin e planifikimit dhe angazhimit institucional të bashkive në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo), Përqindje

Disagregimi: Nuk ka

Formula:

P01₁: Nëse: (Vendimi i Këshillit Bashkiak ekziston dhe është publikuar në faqen zyrtare dhe ekziston procesverbali i mbledhjes së miratimit dhe konfirmimi nga Institucioni i Prefektit, miratimi nga MTM) → P01₁ = “Plan i miratuar në vitin e raportimit”. Ndryshe nëse: (Dokumentet e zbatimit si plani i masave, raporti i zbatimit dhe buxheti janë të disponueshme) → P01₁ = “Plan në zbatim (miratuar më herët)”. Përndryshe: → P01₁ = “Nuk ka plan”.

$P01_2 = (P01.5 / P01.4) \times 100$

Përfshirja në GBP: Ky tregues është gjithashtu pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë.

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **P01.1 Plan Mbarështimi i miratuar**
- **P01.2 Periudha e miratimit të Planit të Mbarështimit**
- **P01.3 Periudha e vlefshmërisë së Planit të Mbarështimit**
- **P01.4 Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki**
- **P01.5 Sipërfaqja e fondit Pyjor dhe Kullosor e mbuluar me Plan Mbarështimi**

P01.1 PLAN MBARËSHTIMI I MIRATUAR

Përshkrimi i të dhënës: Evidenton ekzistencën e planeve të reja të mbarështimit të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Burimi: Njësia përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave

Metoda e mbledhjes: Kontroll i dokumentacionit zyrtar të miratimit të planit: Vendim i miratimit i Këshillit Bashkiak, publikimi zyrtar në faqen e internetit të bashkisë, Urdhri i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit që miraton Planin e Mbarështimit të Pyjeve, konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit, konsiderohet “Po” dhe në të kundërt “Jo”.

Metoda e verifikimit: Numri i Vendimit i miratuar të Këshillit Bashkiak brenda periudhës së raportimit, publikimi zyrtar në faqe të internetit të bashkisë, numri i urdhrit i MTM që miraton Planin e Mbarështimit të Pyjeve brenda periudhës së raportimit, akti i konfirmimit të VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV.

P01.2 PERIUDHA E MIRATIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton periudhën e miratimit të Planit të Mbarështimit i cili mund të jetë para vitit të raportimit, gjatë vitit të raportimit ose përgjatë vitit 2025.

Njësia Matëse: Muaj/Vit

Burimi: Njësia përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve sipas organikës së bashkisë / Drejtoria e Financës

Metoda e mbledhjes: Kontroll i dokumentacionit zyrtar të miratimit të planit: Vendim i miratimit i Këshillit Bashkiak, Urdhri i MTM që miraton Planin e Mbarështimit të Pyjeve, konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit për datën e miratimit të planit.

Metoda e verifikimit: Numri i Vendimit të miratuar i Këshillit Bashkiak brenda periudhës së raportimit, Publikimi zyrtar në faqe të internetit të bashkisë, Numri i urdhrit i MTM që miraton Planin e Mbarështimit të Pyjeve brenda periudhës së raportimit, akti i konfirmimit të VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

P01.3 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton periudhën e vlefshmërisë së Planit të Mbarështimit i cili mund të jetë disa vjeçar.

Njësia Matëse: Numër (muaj nga muaji i raportimit)

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë

Metoda e mbledhjes: Kontroll dokumentacioni dhe statusi i zbatimit të planit

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, linku i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi. Buxhet dhe Plan Zbatimi nëse plani është aprovuar përpara vitit të raportimit. Konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

P01.4 SIPËRFAQJA GJITHSEJ E FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR NË BASHKI

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton sipërfaqen gjithsej që bashkia ka në juridiksion për menaxhim si fond pyjor ose kullor.

Njësia matëse: Hektarë (ha), Kilometër katror(km²)

Burimi: Njësia përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve sipas organikës së bashkisë, regjistri lokal i aseteve dhe VKM-të e transferimit.

Metoda e mbledhjes: Raportim nga bashkia në bazë të inventarit lokal dhe kombëtar (regjistri aseteve të bashkisë dhe VKM-të e transferimit të fondit pyjor dhe kullor)

Metoda e verifikimit: Në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe regjistrin zyrtar të fondit kullosor; në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme; në sistemin shqiptar të informacionit për pyjet “ALFIS” (Albanian Forest Information System).

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AKP, MTM/AMVV/ Njësia e Performancës.

P01.5 SIPËRFAQJA E FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR E MBULUAR ME PLAN MBARËSHTIMI

Përshkrimi i të dhënës: Tregon pjesën e sipërfaqes që është aktualisht është e përfshirë në një plan mbarështimi të miratuar

Njësia matëse: Hektarë (ha), Kilometër katror(km²)

Burimi: Njësia përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve sipas organikës së bashkisë

Metoda e mbledhjes: Nxirret nga planet ekzistuese të mbarështimit

Metoda e verifikimit: Krahasim me regjistrin pyjor dhe planet e miratuara

Institucioni përgjegjës: MTM/AMVV/ Njësia e Performancës.

TREGUESI P02 - PUNONJËS PËR 1,000 HEKTARË

Rezultati i synuar: Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor.

Ky tregues vlerëson burimet njerëzore të dedikuara nga bashkia për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor. Matja e numrit të punonjësve për çdo 1,000 hektarë ndihmon në kuptimin e shkallës së përkushtimit institucional për administrimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e këtyre sipërfaqeve.

Njësia Matëse : Raport : Punonjës/1,000 ha

Disagregimi: Nuk ka

Formula: $P02 = (P02.1 / P01.4) * 1,000$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **P01.4** Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki
- **P02.1** Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor

P02.1 NUMRI I PUNONJËSVE PËR MENAXHIMIN E FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR

Përshkrimi i të dhënës: Tregon numrin e punonjësve të përhershëm ose të përkohshëm të angazhuar në strukturat përgjegjëse të bashkisë për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki / Burimet Njerëzore.

Metoda e mbledhjes: Mbledhja kryhet nëpërmjet deklaramit të numrit të punonjësve nga sektori përkatës dhe/ose zyra e financës në bashki.

Metoda e verifikimit: Të dhënat kontrollohen përmes listëpagesave dhe dokumentacionit të burimeve njerëzore.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

FUSHA: MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm : Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore.

Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrëfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret.

Aktivitetet përfaqësuese përfshijnë :

- Funksionimi dhe pajisja e njësive zjarrëfikëse dhe shërbimeve të emergjencës;
- Zbatimi i masave të parandalimit në ndërtesa publike dhe hapësira komunitare;
- Trajnimi i stafit vendor dhe vullnetarëve për ndërhyrje dhe evakuim;
- Mbështetja e fushatave sensibilizuese për komunitetin në lidhje me rreziqet nga zjarri.

Bazë ligjore: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 29, pika 2, si dhe Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe aktet nënligjore përkatëse.

TREGUESI Z01 - ZJARRËFIKËS PËR 1,500 BANORË

Rezultati i synuar : Punësimi i personelit për mbrojtjen nga zjarri sipas standardit ligjor

Ky tregues mat nivelin e përputhshmërisë së bashkive me standardin ligjor për mbulimin me punonjës zjarrëfikës. Ai ndihmon në vlerësimin e kapaciteteve njerëzore për përballimin e emergjencave dhe ndërhyrjeve në raste zjarri.

Njësia Matëse : Raport: punonjës për 1,500 banorë

Formula: $Z01 = (Z01.1 / \text{Nr. i popullsisë në bashki}) * 1,500$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **Z01.1** Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki
- **Nr. i popullsisë** banuese në bashki

Z01.1 NUMRI I PUNONJËSVE ZJARRËFIKËS NË BASHKI

Përshkrimi i të dhënës: Të dhënat përbëhen nga numri gjithsej i punonjësve aktiv në shërbimin zjarrëfikës që janë të punësuar me kohë të plotë në njësitë përkatëse të bashkisë.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Burimet njerëzore të bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Regjistri i punonjësve të bashkisë.

Metoda e verifikimit: Kontrolli i listëpagesave.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Drejtoria / Njësia e financë-buxhetit / AMVV.

TREGUESI Z02 - AUTOMJETE ZJARRËFIKËSE PËR 10,000 BANORË

Rezultati i synuar: Përmirësimi i infrastrukturës së MZSH

Ky tregues reflekton aftësinë logjistike të bashkive për të përballuar situatat emergjente përmes disponueshmërisë së mjeteve zjarrëfikëse funksionale, sipas standardeve të rekomanduara për shërbimin.

Njësia Matëse: Raport (Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë)

Disagregimi: Nuk ka

Formula: $Z02 = (Z02.1 / \text{Nr. i popullsisë në bashki}) * 10,000$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **Z02.1** Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki
- **Nr. i popullsisë banuese në bashki**

Z02.1 NUMRI I MJETEVE ZJARRËFIKËSE FUNKSIONALE NË BASHKI

Përshkrimi i të dhënës: Të dhënat përfshijnë numrin e mjeteve zjarrëfikëse funksionale (jo jashtë përdorimi) në zotërim të bashkisë dhe të regjistruara zyrtarisht për qëllime ndërhyrjeje emergjente.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Stacioni MZSH

Metoda e mbledhjes: Regjistri / databaza / Njësia teknike për MZSH.

Metoda e verifikimit: Kontrolli i mjeteve në përdorim dhe furnizimi me karburant.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

FUSHA: MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet.

Nëpërmjet këtij funksioni, bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore.

Shembuj të aktiviteteve përfshijnë:

- Mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve;
- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike);
- Dhënien e granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve;
- Monitorimin e ndotjes dhe koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit.

Ky funksion rrjedh nga Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **neni 23 pika 10**, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

Ligji Nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligji nr. 57/2023 (ndryshime në ligjin bazë) si Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve 2020–2035 përcaktojnë detyrimet e bashkive për mbledhjen, transportin, depozitimin dhe përgatitjen e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 708, datë 29.08.2012 – mbi strukturën dhe miratimin e planeve vendore të mbetjeve.

TREGUESI M01- MBULIMI I POPULLSISË ME SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË ZONAT URBANE/RURALE

Rezultati i synuar: Rritja e mbulimit të popullsisë me shërbimin e mbetjeve.

Ky tregues mat përqindjen e popullsisë në bashki që mbulohet me shërbimin e mbledhjes dhe trajtimit të mbetjeve urbane dhe rurale.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregimi: Urban, rural

Formula:

$$M01_1 = (M01.1/Nr. i NJA qendër) * 100$$

$$M01_2 = (M01.2/Nr. i fshatrave) * 100$$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **M01.1** Numri i Njësive Administrative qendër (qytetet) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve
- **M01.2** Numri i fshatrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve
- Numri i fshatrave në territorin e bashkisë
- Numri i qendrave së Njesisë Administrative

M01.1 NUMRI NJËSIVE ADMINISTRATIVE QENDËR TË MBULUAR ME SHËRBIMIN E MBETJEVE

Përshkrimi i të dhënës: Tregon numrin e njësive administrative qendër (qytete) brenda territorit të bashkisë që mbulohen me shërbimin e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Drejtoria teknike përgjegjëse për shërbimin e MIM

Metoda e mbledhjes: Të dhënat mblidhen nga raportet e monitorimit të drejtorisë teknike përgjegjëse për shërbimin e MIM dhe listat e njësive qendër me shërbim aktiv.

Metoda e verifikimit: Kontroll i raporteve zyrtare

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

M01.2 NUMRI I FSHATRAVE TE MBULUAR ME SHËRBIMIN E MBETJEVE

Përshkrimi i të dhënës: Numri i fshatrave në zonat rurale të bashkisë ku ofrohet shërbimi i mbetjeve

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Drejtoria teknike përgjegjëse për shërbimin e MIM.

Metoda e mbledhjes: Popullsia rurale e mbuluar, llogaritur përmes numrit të fshatrave ku ofrohet shërbimi.

Metoda e verifikimit: Verifikimi i raporteve të monitorimit të shërbimit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

TREGUESI M02 - MBETJET E GJENERUARA SI KG/BANOR⁴

Rezultati i synuar: Monitorimi i shërbimit dhe efikasiteti i planifikimit.

Ky tregues mat sasinë mesatare të mbetjeve të prodhuara nga një banor në vit.

Njësia Matëse: Kg/banor

Disagregimi: Nuk ka

Formula: $M02 = (M02.1 / \text{Nr. i popullsisë në bashki})$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **M02.1 Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej (kg)**

⁴ Vlera Reference

Bashki	Mbetje për banor	Burimi
Tiranë	500–600 kg/frymë/vit	GIZ & Co-PLAN (2021). <i>Masterplani i Menaxhimit të Mbetjeve për Qarkun Tiranë</i> .
Shkodër	rreth 450 kg/frymë/vit	AKM & Co-PLAN (2021). <i>Raport Vlerësimi për Sistemin e Mbetjeve në Qarkun Shkodër</i> .
Bashki rurale (p.sh. Dropull, Pustec)	200–300 kg/frymë/vit	Llogaritje nga INSTAT (Statistikat e Mbetjeve, 2023) dhe të dhëna nga projektet e BERZH në juglindje.

- **Nr. i popullsisë banuese në bashki**

M02.1 SASIA E MBETJEVE TË GJENERUARA GJITHSEJ (KG)

Përshkrimi i të dhënës: Sasia e mbetjeve të prodhuara në bashki gjatë vitit të raportimit

Njësia Matëse: Kilogram (kg)

Burimi: Njësia e monitorimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Metoda e mbledhjes: Regjistri i operatorëve të shërbimit / databaza / raporti vjetor i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, sistemet e matjes në pikat e grumbullimit, faturimi i shërbimit dhe të dhëna nga operatorët e kontraktuar për transportin dhe depozitimin e mbetjeve.

Metoda e verifikimit: : Landfilli sanitar / incinerator si pikë fundore e depozitimit të mbetjeve. Vlerësim i sasive sipas mjeteve që depozitohen në fushat e hapura të mbetjeve.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Agjencia Kombëtare e Mjedisit / AMVV / Njësia e Performancës.

TREGUESI M03 - MBULIMI KOSTOS SË MENAXHIMIT TË MBETJEVE NGA TARIFA E SHËRBIMIT

Rezultati i synuar: Rritja e mbulimit të kostos nga tarifa.

Ky tregues mat përqindjen e kostove të menaxhimit të mbetjeve që mbulohen nga të ardhurat e mbledhura përmes tarifës së shërbimit.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregimi: Nuk ka

Formula: $M03 = (M03.1/M03.2) * 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **M03.1** Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve
- **M03.2** Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

M03.1 TË ARDHURAT GJITHSEJ NGA TARIFA E SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Përshkrimi i të dhënës: Vlera e të ardhurave të mbledhura nga tarifa e mbetjeve gjatë vitit të raportimit sipas llojit të taksapaguesit (familje / biznes / institucion publik).

Njësia Matëse: Mijë lekë

Burimi: Thesari MF / drejtoria e financës ose buxhetit në bashki

Metoda e mbledhjes: Raport i thesarit / raporti vjetor i ekzekutimit të buxhetit

Metoda e verifikimit: Verifikim i raportit

Institucioni përgjegjës për verifikimin: MF / AMVV / Njësia e Performancës

M03.2 SHPENZIME GJITHSEJ PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Përshkrimi i të dhënës: Vlera e shpenzimeve të bashkisë për ofrimin e shërbimit të mbetjeve.

Njësia Matëse: Mijë lekë.

Burimi: Thesari MF / drejtorja e financës ose buxhetit në bashki.

Metoda e mbledhjes: Raport i thesarit / raport buxhetor.

Metoda e verifikimit: Verifikim i raportit

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Thesari / MF / AMVV / Njësia e Performancës.

TREGUESI M04 - PLAN VENDOR TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Rezultati i synuar: Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Treguesi mat gjendjen e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve (miratim ose zbatim), që siguron organizim dhe planifikim strategjik të shërbimit.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Disagregimi: Nuk ka

Formula: Nëse: (Vendimi i Këshillit Bashkiak ekziston dhe është publikuar në faqen zyrtare dhe ekziston konfirmimi i Institucionit të Prefektit → M04 = “Plan i miratuar në vitin e raportimit”. Ndryshe nëse: (Dokumentet e zbatimit si plani i masave, raporti i zbatimit dhe buxheti janë të disponueshme) → M04 = “Plan në zbatim (miratuar më herët)”. Përndryshe: → M04 = “Nuk ka plan”.

Përfshirja në GBP: Ky tregues është gjithashtu pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë.

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- M04.1 Plani i Menaxhimit të Mbetjeve i miratuar
- M04.2 Periudha e miratimit të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve
- M04.3 Periudha e vlefshmërisë së Planit të Menaxhimit të Mbetjeve

M04.1 PLANI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE I MIRATUAR

Përshkrimi i të dhënës: Tregon nëse bashkia ka miratuar një plan vendor për menaxhimin e mbetjeve.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Burimi: Njësia e monitorimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Metoda e mbledhjes: Nëse plani i menaxhimit të mbetjeve është miratuar me vendim të KB, është publikuar në faqe të internetit të bashkisë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit, konsiderohet “Po” dhe në të kundërt “Jo”.

Metoda e verifikimit: Vendimi i këshillit bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë brenda periudhës së raportimit, linkun e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse, vendimi i Institucionit të Prefektit që konfirmon VKB.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV.

M04.2 PERIUDHA E MIRATIMIT TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Përshkrimi i të dhënës: Tregon nëse bashkia po zbaton një Plan Vendor të miratuar para vitit të raportimit, gjatë vitit të raportimit ose përgjatë vitit 2025.

Njësia Matëse: Muaj/vit

Burimi: Njësia e monitorimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Metoda e mbledhjes: Kontroll dokumentacioni dhe statusi i planit.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi. Buxhet dhe Plan Zbatimi. Konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV.

M04.3 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton periudhën e vlefshmërisë së Planit të Menaxhimit të Mbetjeve, i cili mund të jetë disa vjeçar.

Njësia Matëse: Numër (muaj nga muaji i raportimit).

Burimi: Njësia e monitorimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Metoda e mbledhjes: Kontrollon nëse Plani Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve është i vlefshëm dhe raportohet periudha e vlefshmërisë së tij.

Metoda e verifikimit: Plani i Masave të Veprimit, Raporti për vitet që plani është në fuqi.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV.

FUSHA: MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet.

Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës.

Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

Bazë ligjore:

Sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 24 (pikat 1–4) përcakton se:

1. Bashkia ka përgjegjësi për ofrimin dhe financimin e shërbimeve sociale për individët dhe familjet në nevojë, në përputhje me legjislacionin përkatës;
2. Këto shërbime përfshijnë ndihmën ekonomike, përfitime në para dhe në natyrë, strehimin social dhe përkujdesje shoqërore;
3. Bashkia ndërton dhe administron infrastrukturën për ofrimin e këtyre shërbimeve (qendra ditore, rezidenciale). **Qendrat ditore** janë struktura që ofrojnë shërbime të përditshme, jo-rezidenciale, për persona në nevojë gjatë orarit të ditës. Ato përfshijnë aktivitete sociale, arsimore, rehabilituese apo ndihmë praktike për: fëmijët me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e dhunës në familje, fëmijët në rrezik social, persona me probleme mendore ose varësi. **Qendrat rezidenciale**, ofrojnë strehim të përkohshëm ose afatgjatë dhe përkujdesje 24-orëshe për individët në nevojë. Ato mund të përfshijnë: shtëpi për fëmijë pa përkujdesje prindërore, shtëpi për të moshuar pa përkrahje, streha për gra dhe vajza viktimat të dhunës dhe trafikimit, shërbime rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara⁵;
4. Ajo miraton dhe zbaton planin vendor të shërbimeve sociale, duke bashkërenduar me agjenci publike dhe jopublike.

TREGUESI S01 - PËRQINDJA E FAMILJEVE QË MARRIN NDIHMË EKONOMIKE

Rezultati i synuar: Reduktim e varfërisë.

Ky tregues vlerëson shkallën e mbulimit të njësive vendore me skemën e ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregimi: Nuk ka

Formula: $S01 = (S01.2 / S01.1) \times 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **S01.1** Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike
- **S01.2** Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike

S01.1 NUMRI I FAMILJEVE QË KANË APLIKUAR PËR NDIHMË EKONOMIKE

⁵ Përkufizimet e qendrave ditore dhe rezidenciale mbështeten në Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, VKM nr. 627/2018 për miratimin e standardeve të shërbimeve dhe Udhëzimin nr. 10, datë 25.12.2019 për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale.

Përshkrimi i të dhënës: Numri i aplikuesve të ndihmës ekonomike gjatë vitit të raportimit, sipas të dhënave të miratuara nga strukturat përgjegjëse të bashkisë

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale dhe/ose administrimin e ndihmës ekonomike në bashki.

Metoda e mbledhjes: Të dhënat merren nga lista e aplikimeve të dorëzuara, të cilat regjistrohen nga punonjësit socialë në sistemin elektronik kombëtar, të administruar nga Shërbimi Social Shtetëror, për vitin e raportimit. Në rastet kur dokumentacioni nuk është i digjitalizuar plotësisht, përdoret edhe dokumentacioni fizik. Të dhënat raportohen si vlerë vjetore.

Metoda e verifikimit: Kontroll i dosjeve të aplikantëve, që kanë aplikuar vitin e raportimit. Krahësim me regjistrin elektronik (sistemi NE), që përmban të dhëna për aplikime dhe përfitime mujore.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: MSHMS / Njësia e Performancës / AMVV

S01.2 NUMRI I FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE

Përshkrimi i të dhënës: Numri i familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike gjatë vitit të raportimit, sipas të dhënave të miratuara nga strukturat përgjegjëse të bashkisë.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale dhe/ose administrimin e ndihmës ekonomike në bashki.

Metoda e mbledhjes: Listat përfundimtare mujore e përfituesve të ndihmës ekonomike, të miratuara nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike (NE) dhe me vendim të këshillit bashkiak (VKB). Listat përfshijnë edhe përfituesit e ndihmës së përkohshme në kuadër të masës shtesë prej 6%, në përputhje me VKM nr. 597, datë 4.10.2017.

Metoda e verifikimit: Vendimet zyrtare të KB për përfituesit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: MSHMS / Njësia e Performancës / AMVV.

TREGUESI S02 - SHKALLA E MIRATIMIT TË STREHIMIT SOCIAL

Rezultati i synuar: Rritja e qasjes në shërbime të strehimit social për individët/familjet në nevojë.

Ky tregues mat përqindjen e individëve/familjeve që kanë përfituar nga programet e strehimit social krahasuar me numrin total të aplikimeve të paraqitura gjatë një periudhe raportimi. Ky tregues reflekton kapacitetin e bashkisë për të trajtuar kërkesat dhe për të siguruar akses real në mbështetje për strehim për grupet në nevojë, në përputhje me Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregimi: Nuk ka

Formula: $S02 = (S02.2 / S02.1) \times 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- S02.1 Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social

- **S02.2 Numri i personave përfitues të strehimit social**

S02.1 NUMRI I PERSONAVE QË KANË PARAQITUR KËRKESË PËR STREHIM SOCIAL

Përshkrimi i të dhënës: Tregon numrin total të individëve ose familjeve që kanë dorëzuar një kërkesë zyrtare për përfitim nga programet e strehimit social gjatë vitit raportues, në përputhje me kriteret e Ligjit nr. 22/2018 dhe VKM-të përkatëse që rregullojnë procedurat e aplikimit.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për strehimin social në bashki.

Metoda e mbledhjes: Kërkesat e dorëzuara dhe dokumentacioni i aplikantëve, dosjet fizike të aplikantëve (dokumentacioni i dorëzuar sipas kërkesave të ligjit), regjistri elektronik i aplikimeve (nëse ekziston), arkiva e protokolleve për pranimin e kërkesave.

Metoda e verifikimit: Dosjet fizike të aplikantëve (dokumentacioni i dorëzuar sipas kërkesave të ligjit), regjistri elektronik i aplikimeve (nëse ekziston), arkiva e protokolleve për pranimin e kërkesave

Institucioni përgjegjës për verifikimin: MEKI / Njësia e Performancës / AMVV.

S02.2 NUMRI I PERSONAVE PËRFITUES TË STREHIMIT SOCIAL

Përshkrimi i të dhënës: Tregon numrin e individëve ose familjeve që kanë përfituar një formë mbështetjeje për strehim nga programet e strehimit social gjatë vitit raportues, përmes një vendimi të miratuar nga Këshilli Bashkiak sipas ligjit nr. 22/2018 dhe vendimeve përkatëse, gjatë vitit raportues.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për strehimin social në bashki.

Metoda e mbledhjes: Vendimet e miratuara për përfituesit dhe regjistri i i përfituesve të strehimit sipas programit përkatës (bonusi i qirasë, banesë sociale, etj.).

Metoda e verifikimit: Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratim të përfitimit, dosjet e dokumentacionit për secilin përfitues, raportime periodike të njësisë për strehim ndaj organeve përgjegjëse.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: MEKI / Njësia e Performancës / AMVV.

TREGUESI S03 - NUMRI I QENDRAVE SOCIALE KOMUNITARE PUBLIKE, TE LICENSUARA PËR 10,000 BANORË

Rezultati i synuar: Rritja e aksesit në qendra sociale komunitare.

Ky tregues mat aksesin në shërbime sociale në nivel vendor përmes numrit të qendrave komunitare publike funksionale dhe të licencuara që operojnë në territorin e bashkisë, raportuar ndaj çdo 10,000 banorëve. Përfshin si qendrat ditore, ashtu edhe ato rezidenciale, të cilat ofrojnë mbështetje për individë dhe familje në nevojë, në përputhje me Ligjin nr. 121/2016 dhe VKM nr. 627/2018.

Njësia Matëse: Numër

Disagregimi: Nuk ka

Formula: S03: $((S03.1 + S03.2)/\text{Nr. i popullsisë}) \cdot 10,000$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **S03.1 Numri i qendrave sociale ditore funksionale**
- **S03.2 Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale**
- **Nr. i popullsisë banuese në bashki**

S03.1 NUMRI I QENDRAVE SOCIALE DITORE FUNKSIONALE, TË LICENSUARA

Përshkrimi i të dhënës: Tregon numrin e qendrave sociale komunitare **ditore**, publike, të cilat ofrojnë mbështetje të përditshme (pa strehim) për individë ose grupe vulnerabël, gjatë vitit raportues. **Qendrat ditore** janë struktura që ofrojnë shërbime të përditshme, jo-rezidenciale, për persona në nevojë gjatë orarit të ditës. Ato përfshijnë aktivitete sociale, arsimore, rehabilituese apo ndihmë praktike për: fëmijët me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhe trafikimin e qenieve njerëzore, fëmijët në rrezik social, persona me probleme mendore ose varësi.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki.

Metoda e mbledhjes: Lista e qendrave ditore publike në funksion, dokumentacion mbi statusin aktiv (shpenzime operacionale, staf, shërbime të ofruara, orar pune), raportimet nga vetë qendrat dhe verifikimi për licencim aktiv.

Metoda e verifikimit: Kontroll i dokumentacionit financiar dhe listës së stafit, Raportimet periodike të qendrave, Dokumentacioni i licencimit sipas Udhëzimit Nr. 10, datë 25.12.2019, Inspektimet të rastësishme nga njësia e performancës ose grupi monitorues.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: MSHMS / Njësia e Performancës / AMVV.

S03.2 NUMRI I QENDRAVE SOCIALE REZIDENCIALE FUNKSIONALE, TË LICENSUARA

Përshkrimi i të dhënës: Tregon numrin e qendrave **rezidenciale** komunitare publike që funksionojnë gjatë vitit raportues dhe ofrojnë **strehim të përhershëm ose të përkohshëm** dhe përkujdesje të plotë 24-orëshe për persona në nevojë. **Qendrat rezidenciale**, ofrojnë strehim të përkohshëm ose afatgjatë dhe përkujdesje 24-orëshe për individët në nevojë. Ato mund të përfshijnë: shtëpi për fëmijë pa përkujdesje prindërore, shtëpi për të moshuar pa përkrahje, streha (emergjente apo afatgjata) për gra dhe vajza viktimat të dhunës dhe trafikimit, shërbime rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara⁶

Njësia Matëse : Numër

⁶ Përkufizimet e qendrave ditore dhe rezidenciale mbështeten në Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, VKM nr. 627/2018 për miratimin e standardeve të shërbimeve dhe Udhëzimin nr. 10, datë 25.12.2019 për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale.

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki.

Metoda e mbledhjes: Regjistri i qendrave rezidenciale publike ose private të licensuara, vendime të Këshillit Bashkiak për themelimin ose bashkëfinancimin, raporte vjetore nga njësia e mbulimit të shërbimit.

Metoda e verifikimit: Dokumentacion mbi licencimin dhe autorizimin për operim, raporte të shërbimeve dhe përditësime të kapacitetit akomodues, inspektime të rregullta për përmbushjen e standardeve shtetërore (VKM nr. 627/2018), krahasim me të dhënat e MSHMS.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: MSHMS / Njësia e Performancës / AMVV / Njësia përgjegjëse për ofrimin e shërbimit në bashki.

TREGUESI S04 - PËRQINDJA E RASTEVE TË REFERUARA NGA MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT (MKR) QË PËRFITOJNË SHËRBIME SOCIALE

Rezultati i synuar: Përmirësimi i sistemit të identifikimit dhe ndjekjes së rasteve të dhunës në familje

Ky tregues mat efikasitetin e ndjekjes institucionale të rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës ndaj grave⁷ nga strukturat vendore, përmes raportit midis numrit të rasteve të referuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit⁸ dhe atyre që kanë përfituar realisht shërbime sociale. Shërbimet përfshirë janë: këshillim psiko-social, mbështetje juridike, ndihmë ekonomike, mbështetje ekonomike si rrjedhojë e pajisjes me urdhër mbrotjeje, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së urdhërit, shërbim strehimi të përkohshëm, shërbim strehimi afatgjatë (bonus qeraje apo banesë sociale), shoqërim institucional dhe masa të tjera mbrojtëse.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregim: Gjinor, Grupmoshë

Formula: $S04 = (S04.2 / S04.1) * 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **S04.1 Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës ndaj grave të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit (MKR)⁹**

⁷ Sipas VKM 327/2021, pjesa III, neni 1.1 “KV-ja raporton e identifikon edhe rastet e tjera të dhunës së ushtruar ndaj grave, të parashikuara në Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, sipas kësaj pike.”. Pra MKR trajton jo vetëm rastet e dhunës në familje, por të gjitha rastet e dhunës ndaj grave, të parashikuara në Këtë Konventë.

⁸ VKM nr. 327, datë 12.06.2021, “Për Mekanizmin e Bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për Referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës”.

⁹ Sipas VKM 327/2021, pjesa II, neni 31, pika h) “...secili anëtar i ekipit ndërdisiplinor ka përgjegjësi që të përcjellë te KV-ja, një herë në muaj, informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni i tij, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore apo është trajtuar vetëm brenda për brenda institucionit të vet”. Shih edhe pjesa III, neni 13 për më shumë detaje mbi mënyrën e mbledhjes dhe administrimit të të dhënave.

- **S04.2 Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës ndaj grave të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale**

S04.1 NUMRI I RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE TË REFERUARA NGA MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT (MKR).

Përshkrimi i të dhënës: Raste të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës ndaj grave të referuara nga institucionet përbërëse të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (që kryesohet nga bashkia dhe ka në përbërje anëtarë të përhershëm si: policia, shërbimi shëndetësor, shërbimi i arsimit, shërbimi social në bashki apo qark, Prefektin e Qarkut, Qarkun, zyrat e punësimit, OJF-të, etj., si dhe të ftuar një sërë institucionesh të tjera.)¹⁰ pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për mbrojtje dhe trajtim.

Disagregimi: Gjinor, Grupmoshë

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Policia e Shtetit dhe Koordinatorja/Koordinatori Vendor¹¹ në bashki (Drejtoria e Shërbimit Social në bashki).

Metoda e mbledhjes: Sistemi REVALB¹² ku hidhen të dhënat për menaxhimin e rasteve nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit, regjistri i rasteve të referuara (në bashki), si dhe formularët e referimit të rasteve që dërgohen të plotësuara nga anëtarët e MKR (sidomos nga policia e shtetit).

Metoda e verifikimit: Formulari i referimit të rasteve dhe dokumentacioni shoqërues përkatës i raportimeve, sipas Protokolleve për Menaxhimin e Rasteve, si dhe dokumentacioni zyrtar shoqërues nga institucionet përkatëse.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit Shqiptar / Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale / Njësia e Performancës / AMVV

S04.2 NUMRI I RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE TË REFERUARA NGA MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT (MKR) TË CILAT KANË PËRFITUAR SHËRBIME SOCIALE

Përshkrimi i të dhënës: Numri i rasteve të referuara që kanë përfituar të paktën një formë ndërhyrjeje të strukturuar pas referimit (strehim emergjent ose afatgjatë, mbështetje psiko-sociale, ndihmë ekonomike, mbështetje ekonomike si rrjedhojë e pajisjes me urdhër mbrojtjeje dhe përgjatë gjithë kohëzgjatjes së këtij urdhëri, përkujdesje në qendër sociale, trajtim në qendrat e referimit të sulmeve seksuale, etj.)**Disagregimi:** Gjinor, Grupmoshë

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Koordinatorja/Koordinatori Vendor në bashki (Drejtoria e Shërbimit Social dhe drejtori të tjera përkatëse në bashki), si dhe qendrat e shërbimeve mbështetëse të specializuara

¹⁰ Për më shumë shih VKM 327/2021, pjesa II, nenet 6 dhe 8.

¹¹ Sipas VKM 327/2021, pjesa I, neni 2, a) “Koordinator vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare”, punonjësi pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, përgjegjës për referimin e menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

¹² Sipas VKM 327/2021, neni 2, pika e) “REVALB”, sistemi elektronik i regjistrimit dhe i ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës në familje pranë njësisë vendore.

Metoda e mbledhjes: Raportime të trajtimit nga strukturat përkatëse (qendrat e shërbimeve mbështetëse të specializuara) pranë bashkisë, lista përfituesesh/përfituesish, dosje rastesh. **Metoda e verifikimit:**

Dokumentacioni i shërbimeve të ofruara, regjistrat e qendrave, vendimet për masa mbrojtëse dhe vendimet për trajtime të mëtejshme në shërbimet sociale të përgjithshme apo të specializuara në nivel bashkie, ose qarku; të dhëna dhe raportim nga OJF-të përkatëse që ofrojnë shërbime të specializuara për këto raste.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit Shqiptar (DVP) / Shërbimi Social Shtetëror / Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/ Njësia e Performancës/AMVV

TREGUESI S05 - PËRQINDJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR, TË REFERUAR NGA KOMISIONET BIO-PSIKO-SOCIALE QË MARRIN MBËSHTETJE SOCIALE TË INTEGRUARA

Rezultati i synuar: Përmirësimi i aksesit në shërbime sociale për personat me aftësi të kufizuara.

Ky tregues mat raportin ndërmjet numrit të personave me aftësi të kufizuara të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale për marrje shërbimesh sociale dhe atyre që realisht marrin mbështetje të integruar si pasojë e këtij referimi.

Me “shërbime të integruara” nënkuptohen ndërhyrje të ndryshme që kombinojnë përkujdesje sociale, akses fizik, shërbime komunitare, përfshirje arsimore dhe masa mbështetëse për autonominë dhe përfshirjen e PAK në komunitet.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregimi: Gjinor, grupmoshë

Formula: $S05 = (S05.2 / S05.1) * 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **S05.1** Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale
- **S05.2** Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit

S05.1 NUMRI I PAK TË REFERUAR NGA SHËRBIMET BIO-PSIKO-SOCIALE PËR TË MARRË SHËRBIME SOCIALE

Përshkrimi i të dhënës: Tregon numrin e personave me aftësi të kufizuara që janë vlerësuar nga komisionet bio-psiko-sociale dhe janë **referuar zyrtarisht** për përfitim nga një ose më shumë shërbime sociale në territorin e bashkisë. Shembuj të shërbimeve për të cilat referohen:

- Qendra ditore për PAK;
- Mbështetje për transport të përshtatur;
- Pajisje ndihmëse (karroca, proteza, pajisje për komunikim);
- Shërbime në banesë (kujdestarë);
- Pagesë për shoqërues të fëmijës me aftësi të kufizuara;
- Prioritet në programe strehimi apo ndihmë ekonomike;
- Mbrojtje nga diskriminimi ose ndërmjetësim për punësim të mbrojtur.

Njësia Matëse: Numër

Disagregimi: Gjinor, grupmoshë

Burimi: Komisionet dhe Njësia përgjegjëse për Shërbime Sociale në bashki.

Metoda e mbledhjes: Regjistrat e komisioneve bio-psiko-sociale për çdo rast të vlerësuar, protokollet dhe formularët e referimit të dërguar në bashki, raportet periodike të komisioneve drejt strukturave vendore.

Metoda e verifikimit: Procesverbalet e seancave të komisionit, dosjet individuale të vlerësimit dhe referimit, evidenca zyrtare e dërgimit të rastit për trajtim.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

S05.2 NUMRI I PAK QË MARRIN MBËSHTETJE SI PASOJË E REFERIMIT

Përshkrimi i të dhënës: Tregon numrin e personave me aftësi të kufizuara që, pas vlerësimit nga komisionet dhe referimit për trajtim, kanë përfituar realisht një ose më shumë shërbime mbështetëse të integruara.

Shembuj të shërbimeve të integruara të përfituara:

- Kujdes ditor në qendra të specializuara;
- Terapi psiko-sociale ose edukative në institucion publik apo privat;
- Pajisje ndihmëse të ofruara nga bashkia;
- Transport i mbuluar për ndjekje terapie;
- Mbështetje ekonomike shtesë për trajtim të zgjatur;
- Ndihmë për përshtatje banese (akses për lëvizje);
- Asistent personal ose përkthyes për PAK me dëmtime shqisore;
- Mbështetje ligjore apo ndërmjetësim për përfshirje në arsim.

Njësia Matëse: Numër

Disagregimi: Gjinor, grupmoshë

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki dhe qendrat për aftësi të kufizuara.

Metoda e mbledhjes: Regjistrat e qendrave ditore ose rezidenciale për PAK, raporte mujore dhe vjetore të mbështetjes së ofruar, evidenca nga pagesat për shërbime të kontraktuara ose të ofruara drejtpërdrejt

Metoda e verifikimit: Dokumentacioni i trajtimit, dosje individuale të përfituesve, raporte të stafit profesionist (psikologë, punonjës socialë), verifikim i shërbimit përmes formularëve të ndjekjes pas referimit të shërbimeve.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: MSHMS / Njësia e Performancës / AMVV.

TREGUESI S06 - PLAN VENDOR SOCIAL

Rezultati i synuar: Rritja e kapaciteteve vendore për planifikimin e politikave sociale të përgjigjshme gjinore në nivel vendor dhe përputhshmëria me kuadrin strategjik kombëtar.

Ky tregues vlerëson ekzistencën dhe zbatimin e Planit Social Vendor si dokument strategjik për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor, icili përfshin edhe perspektivën gjinore të integruar.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Disagregimi: Nuk ka

Formula: S06 = Nëse: (Vendimi i Këshillit Bashkiak ekziston dhe është publikuar në faqen zyrtare, ekziston konfirmimi i institucionit të Prefektit të Qarkut dhe procesverbal i VKB-së nënshkruar nga 3 anëtarë) → S06= “Plan i miratuar në vitin e raportimit”. Ndryshe nëse: (Dokumentet e zbatimit si plani i masave, raporti i zbatimit dhe buxheti janë të disponueshme) → S06 = “Plan në zbatim (miratuar më herët)”.

Përfshirja në GBP: Ky tregues është gjithashtu pjesë e kritereve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë.

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **S06.1 Plani Vendor Social i miratuar**
- **S06.2 Periudha e miratimit të Planit Social Vendor**
- **S06.3 Periudha e vlefshmërisë së Planit Social Vendor**

S06.1 PLANI VENDOR SOCIAL I MIRATUAR

Përshkrimi i të dhënës: E dhëna pasqyron nëse bashkia ka hartuar dhe miratuar një Plan Social Vendor.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki.

Metoda e mbledhjes: Nëse Plani Vendor Social është miratuar me vendim të KB brenda datës së raportimit, është publikuar në faqe të internetit të bashkisë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit dhe ka procesverbal të mbledhjes së Këshillit Bashkiak në të cilën është miratuar vendimi, konsiderohet “Po” dhe në të kundërt “Jo”.

Metoda e verifikimit: Nëse Plani Vendor Social është miratuar me vendim të KB, është publikuar në faqe të internetit të bashkisë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit dhe ka procesverbal të mbledhjes së Këshillit Bashkiak në të cilën është miratuar vendimi, konsiderohet “Po” dhe në të kundërt “Jo”.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

S06.2 PERIUDHA E MIRATIMIT TË PLANIT SOCIAL VENDOR

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton periudhën e miratimit të Planit Social Vendor, i cili mund të jetë para vitit të raportimit, gjatë vitit të raportimit ose përgjatë vitit 2025.

Njësia Matëse: Muaj/vit

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki.

Metoda e mbledhjes: Kontroll dokumentacioni dhe statusi i planit.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, linku i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit

Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi. Buxhet dhe Plan Zbatimi nëse plani është aprovuar përpara vitit të raportimit. Konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjes për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

S06.3 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË PLANIT SOCIAL VENDOR

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton periudhën e vlefshmërisë së Planit Social Vendor, i cili mund të jetë disa vjeçar.

Njësia Matëse: Numër (muaj nga muaji i raportimit)

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Kontroll dokumentacioni dhe statusi i planit.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, link-u i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi. Buxhet dhe Plan Zbatimi nëse plani është aprovuar përpara vitit të raportimit. Konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV.

KATEGORIA: MIRËQEVERISJA

FUSHA: BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit – duke përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin aktiv dhe të larguar.

Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për 1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë strukturore (administratë ose njësi shpenzuese).

Bazë ligjore:

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i njeh bashkive autoritetin për organizimin e administratës së tyre dhe menaxhimin e personelit në përputhje me strukturën miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Për më tepër, Ligji Nr. 7961/1995 “Kodi i Punës”, si dhe legjislacioni për shërbimin civil dhe aktet nënligjore për planifikimin e burimeve njerëzore përcaktojnë rregullat për trajtimin, trajnimet dhe procedurat për rekrutimin dhe largimin nga puna të stafit.

TREGUESI NJ01 - SHKALLA E ROTACIONIT TË PUNONJËSVE TË BASHKISË

Rezultati i synuar: Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore

Ky tregues mat shkallën e rotacionit të stafit në bashki gjatë një viti.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregim: Gjinator, Funkcional (administratë, njësi shpenzuese)

Formula : $NJ01 = (NJ01.2 / NJ01.1) \times 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit :

- **NJ01.1** Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit
- **NJ01.2** Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit

NJ01.1 NUMRI I PUNONJËSVE NË BASHKI GJATË VITIT TË RAPORTIMIT

Përshkrimi i të dhënës : Përfshin të gjithë punonjësit e administratës dhe njësive shpenzuese (pa përfshirë shërbimet e nënkontraktuara).

Disagregimi: Gjinator, Funkcional (administratë, njësi shpenzuese)

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Sektori i burimeve njerëzore në bashki.

Metoda e mbledhjes: Dosjet e personelit dhe lista e deklaruar në thesar.

Metoda e verifikimit: Verifikim me thesarin dhe regjistrin e personelit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

NJ01.2 NUMRI I PUNONJËSVE TË LARGUAR NGA BASHKIA GJATË VITIT TË RAPORTIMIT

Përshkrimi i të dhënës: Përfshin punonjësit e larguar nga administrata dhe njësitë shpenzuese gjatë vitit (pa përfshirë kontraktorët).

Disagregimi: Gjinator, Funkcional (administratë, njësi shpenzuese).

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Sektori i burimeve njerëzore në bashki.

Metoda e mbledhjes: Deklaratat e largimit dhe dokumentacioni përkatës nga personeli.

Metoda e verifikimit: Regjistri i burimeve njerëzore dhe raportet zyrtare.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV.

TREGUESI NJ02 - PËRQINDJA E STAFIT TË PUNËSUAR NGA BASHKIA TË TRAJNUAR

Rezultati i synuar: Rritja e kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve.

Ky tregues mat përqindjen e stafit të bashkisë që ka marrë pjesë në trajnime gjatë vitit.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregimi: Gjinator, Funkcional (administratë, njësi shpenzuese).

Formula : $NJ02 = (NJ02.1 / NJ01.1) \times 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit :

- **NJ01.1** Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit
- **NJ02.1** Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit

NJ02.1 NUMRI I PUNONJËSVE TË TRAJNUAR GJATË VITIT

Përshkrimi i të dhënës: Të gjithë punonjësit e trajnuar të administratës dhe njësive shpenzuese në bashki.

Disagregimi: Gjinator, Funkcional (administratë, njësi shpenzuese).

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Sektori i burimeve njerëzore në bashki dhe evidenca e pjesëmarrjes në trajnime.

Metoda e mbledhjes: Lista e pjesëmarrësve dhe certifikatat e trajnimeve

Metoda e verifikimit: Regjistri i trajnimeve, firmat e pjesëmarrjes dhe raportet përkatëse.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

TREGUESI NJ03- PUNONJËS PËR 1'000 BANORË

Rezultati i synuar: Rritja e kapaciteteve të bashkisë për ofrimin e shërbimeve.

Ky tregues mat ngarkesën e stafit të bashkisë në raport me popullsinë banuese.

Njësia Matëse : Numër, Raport : Punonjës/1000 banorë

Disagregimi: Nuk ka

Formula: $NJ03 = (NJ03.1 + NJ01.1) / \text{Nr. Popullsisë në bashki}) \times 1,000$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **NJ03.1** Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit
- **Nr. i popullsisë banuese në bashki**

NJ03.1 NUMRI I PUNONJËSVE TË SHËRBIMEVE TË NËNKONTRAKTUARA NË BASHKI GJATË VITIT TË RAPORTIMIT

Përshkrimi i të dhënës: Përfshin vetëm punonjësit e angazhuar përmes kontratave të nënkontraktuara nga bashkia për ofrimin e shërbimeve

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Sektori i prokurimeve dhe raportet nga subjektet e kontraktuara

Metoda e mbledhjes: Kontratat dhe raportet mujore të ofrimit të shërbimeve

Metoda e verifikimit: Lista e stafit të deklaruar nga subjektet nënkontraktuese dhe konfirmimi i njësive bashkiake.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

FUSHA: TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Përshkrim i përgjithshëm : Transparenca dhe llogaridhënia janë elementë thelbësorë të qeverisjes së mirë në nivel vendor. Bashkitë kanë detyrimin të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës, të publikojnë informacionin mbi veprimtarinë institucionale dhe të japin llogari për realizimin e detyrave të tyre. Këto parime përforcojnë besimin e publikut, përmirësojnë shërbimet dhe parandalojnë abuzimet me pushtetin.

Në këtë kuadër, bashkitë duhet të garantojnë : (i) zhvillimin e konsultimeve publike për aktet me ndikim në komunitet ; (ii) publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe dokumenteve të rëndësishme si Plani Buxhetor Afatmesëm, Paketa Fiskale dhe raportet vjetore të transparencës ; (iii) hartimin dhe zbatimin e planeve të integritetit për të forcuar etikën institucionale.

Baza Ligjore :

Ky funksion është i mbështetur nga Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe udhëzimet dhe modelet e hartuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Zbatimi i këtyre detyrimeve kontribuon në ndërtimin e një administrate vendore të përgjegjshme dhe të hapur ndaj qytetarëve.

TREGUESI T01. AKTE PËR TË CILËT ËSHTË I DETYRUESHËM ZHVILLIMI I KONSULTIMIT PUBLIK

Rezultati i synuar: Rritja e pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të bashkisë.

Ky tregues mat përqindjen e akteve për të cilat është zhvilluar konsultim publik mbi numrin gjithsej të akteve për të cilat konsultimi është i detyrueshëm¹³.

Njësia Matëse : Përqindje

Disagregimi: Nuk ka

Formula : $T01 = (T01.2 / T01.1) \times 100$

¹³ **Paketa Fiskale dhe Buxhetore:** PBA, Vendosija dhe ndryshimi i taksave dhe tarifave vendore, Programi i investimeve publike (veprat në komunitet)

Planifikimi Territorit dhe Pronave: Planet vendore, Vendime për dhënie në përdorim ose me qira të pronave publike, Vendime për zhvendosje ose shpronësim për interes publik, Vendime për ndryshimin e kufijve administrativë të njësive
Shërbimet Publike dhe Sociale: Hartimi i planit vendor të shërbimeve sociale, Draft-rregullore për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve publike (transport urban, ndriçim, ujësjellës, etj.)

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit :

- **T01.1** Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik
- **T01.2** Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik

T01.1 NUMRI I AKTEVE GJITHSEJ PËR TË CILAT ËSHTË I DETYRUESHËM ZHVILLIMI I KONSULTIMIT PUBLIK

Përshkrimi i të dhënës: Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Sekretari i Këshillit Bashkiak

Metoda e mbledhjes: Krahësim i listës së akteve që duhen miratuar me bazën ligjore të akteve që kërkojnë konsultim.

Metoda e verifikimit: Verifikimi nga Institucioni i Prefektit nëpërmjet listës së akteve dhe bazës ligjore.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV / Institucioni i Prefektit

T01.2 NUMRI I AKTEVE PËR TË CILËT ËSHTË ZHVILLUAR KONSULTIMI PUBLIK

Përshkrimi i të dhënës: Numri i rasteve kur konsultimi publik është zhvilluar me dokumentim të plotë sipas ligjit.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Sekretari i Këshillit Bashkiak

Metoda e mbledhjes: Regjistri i konsultimeve publike, procesverbalet dhe njoftimet për konsultim.

Metoda e verifikimit: Kontroll nga Prefekti mbi dokumentacionin e konsultimit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV / Institucioni i Prefektit

TREGUESI T02 - RAPORTI VJETOR PËR TRANSPARENCËN NË PROCESIN E VENDIMMARRJES

Rezultati i synuar : Rritja e llogaridhënies dhe transparencës institucionale.

Ky tregues mat përmbushjen e detyrimit ligjor për publikimin e raportit vjetor të transparencës në faqen zyrtare të bashkisë.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Disagregimi: Nuk ka

Formula: T02 = “Po” nese Raporti ekziston dhe është publikuar në faqe zyrtare, në të kundërt “Jo”.

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **T02.1** Publikimi i raportit vjetor për transparencën

T02.1 PUBLIKIMI I RAPORTIT VJETOR PËR TRANSPARENCËN

Përshkrimi i të dhënës : Tregon nëse bashkia ka publikuar raportin vjetor për transparencën sipas modelit të Komisionerit.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Burimi: Koordinator i Transparencës ose Njësia e Marrëdhënieve me Publikun.

Metoda e mbledhjes: Verifikim në faqen zyrtare të bashkisë

Metoda e verifikimit: Kontroll online dhe dokument zyrtar

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

TREGUESI T03- PLAN VENDOR I INTEGRITETIT

Rezultati i synuar: Forcimi i etikës institucionale dhe parandalimi i korrupsionit.

Ky tregues vlerëson nëse bashkia ka miratuar dhe ka zbatuar një plan integriteti për të forcuar etikën institucionale dhe parandalimin e korrupsionit.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Disagregimi: Nuk ka

Formula: Nëse: (Vendimi i Këshillit Bashkiak ekziston dhe është publikuar në faqen zyrtare, ekziston konfirmimi i Institucionit të Prefektit dhe procesverbal i VKB nënshkruar nga 3 anëtarë) → T03= “Plan i miratuar në vitin e raportimit”. Ndryshe nëse: (Dokumentet e zbatimit si plani i masave, raporti i zbatimit dhe buxheti janë të disponueshme) → T03 = “Plan në zbatim (miratuar më herët)”. Përndryshe: → T03 = “Nuk ka plan”.

Përfshirja në GBP: Ky tregues është gjithashtu pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë.

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- T03.1 Plani Vendor i Integritetit i miratuar
- T03.2 Periudha e miratimit të Planit të Integritetit
- T03.3 Periudha e vlefshmërisë së Planit të Integritetit

T03.1 PLANI VENDOR I INTEGRITETIT I MIRATUAR

Përshkrimi i të dhënës: E dhëna pasqyron nëse bashkia ka hartuar dhe miratuar një Plan Vendor të Integritetit.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Burimi: Koordinator i Transparencës ose Njësia e Marrëdhënieve me Publikun.

Metoda e mbledhjes: Kontrollohet nëse Plani Vendor i Integritetit është zbatuar. Treguesi raportohet si “Po” nëse ka prova që plani është zbatuar dhe dokumentat janë prezent (plani i masave, raporti i zbatimit, buxheti) dhe në të kundërt “Jo”.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, linku i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse, vendimi i Institucionit të Prefektit që konfirmon VKB, procesverbali i nënshkruar nga tre anëtarë të këshillit bashkiak me rezultatet e votimit për vendimin.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës

T03.2 PERIUDHA E MIRATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton periudhën e miratimit të Planit të Integritetit i cili mund të jetë para vitit të raportimit, gjatë vitit të raportimit ose përgjatë vitit 2025.

Njësia Matëse: Muaj/Vit

Burimi: Koordinator i Transparencës ose Njësia e Marrëdhënieve me Publikun

Metoda e mbledhjes: Kontroll dokumentacioni dhe statusi i planit.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, linku i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi. Buxhet dhe Plan Zbatimi nëse plani është aprovuar përpara vitit të raportimit. Konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

T03.3 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË PLANIT TË INTEGRITETIT

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton periudhën e vlefshmërisë së Planit të Integritetit, i cili mund të jetë disa vjeçar.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Koordinator i Transparencës ose Njësia e Marrëdhënieve me Publikun.

Metoda e mbledhjes: Kontroll dokumentacioni dhe statusi i zbatimit të planit.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, linku i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi. Buxhet dhe Plan Zbatimi nëse plani është aprovuar përpara vitit të raportimit. Konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

TREGUESI T04 – PUBLIKIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

TREGUESI T05 – PUBLIKIMI I PLANIT BUXHETOR AFATMESËM PBA

2024–2026

TREGUESI T06 – PUBLIKIMI I PAKETËS FISKALE 2024

Treguesit T04 – T05 nuk do të raportohen nga bashkitë, pasi janë monitoruar tashmë dhe vlerësuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në një publikim të dedikuar mbi Indeks të Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, 2024¹⁴.

FUSHA: BARAZIA GJINORE

Përshkrim i përgjithshëm: Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve.

Në këtë kontekst, bashkitë duhet të garantojnë:

- pjesëmarrje të barabartë gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe administrative;
- buxhetim të përgjigjshëm gjinor (gender-responsive budgeting), sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi;
- ofrim shërbimesh që adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre;
- mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination) dhe dhuna me bazë gjinore.

Bashkitë janë të detyruara të raportojnë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione kyçe, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Baza ligjore përfshin:

- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 15 dhe 24;
- Ligji Nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030;
- Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar (neni 2, pika 8);
- Rekomandimet e KQZ për kuotat gjinore në këshillat bashkiakë;
- Rregullorja e brendshme e bashkisë për politikën gjinore, nëse ekziston.

¹⁴ <https://idp.al/wp-content/uploads/2025/02/Indeksi-i-Transparences-proaktive-te-njesive-te-veteqeverisjes-vendore-viti-2024.pdf>

TREGUESI GJ01 - PËRQINDJA E GRAVE NË POZICIONE: KRYETARE, ZV.KRYETARE, ANËTARE NË KËSHILL BASHKIAK DHE ADMINISTRATORE

Rezultati i synuar: Rritja e përfaqësimit gjinor në nivel të lartë vendimmarrës në vetëqeverisjen vendore.

Ky tregues mat nivelin e përfaqësimit gjinor në pozicionet politike dhe administrative në nivel vendor. Ai pasqyron numrin e grave dhe të rejave që ushtrojnë funksione drejtimi politik ose ekzekutiv në bashki, si një tregues i barazisë gjinore në vetëqeverisjen vendore.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregimi: Nuk ka

Formula: $GJ01 = (GJ01.2 / GJ01.1) \times 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **GJ01.1** Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).
- **GJ01.2** Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore

GJ01.1 NUMRI GJITHSEJ I POZICIONEVE DREJTUESE NË BASHKI (KRYETARE/KRYETAR BASHKIE, ZV.KRYETARE/ZV.KRYETAR BASHKIE, ADMINISTRATORE/ADMINISTRATOR, ANËTARE/ANËTAR KËSHILLI)

Përshkrimi i të dhënës: Numri gjithsej i pozicioneve: Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtar Këshilli.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashki.

Metoda e mbledhjes: Nxirret nga organigrama e bashkisë

Metoda e verifikimit: Kontroll i dokumentacionit të burimeve njerëzore

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

GJ01.2 NUMRI I GRAVE NË POZICIONE DREJTUESE NË BASHKI: KRYETARE, ZV.KRYETARE, ANËTARE TË KËSHILLIT BASHKIAK DHE ADMINISTRATORE

Përshkrimi i të dhënës: Numri i grave dhe të rejave që mbajnë pozicione: Kryetare Bashkie, Zv.Kryetare Bashkie, Administratore, Anëtare Këshilli.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashki

Metoda e mbledhjes: Nxirret nga dosjet e personelit

Metoda e verifikimit: Kontroll i dokumentacionit të burimeve njerëzore.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV / Institucioni i Prefektit.

TREGUESI GJ02 - PËRQINDJA E GRAVE NË POZICIONE DREJTUESE TË NDRYSHME (TË LARTË, TË MESME, TË ULËT) NË BASHKI

Rezultati i synuar: Sigurimi i përfaqësimit të barabartë gjinor në menaxhimin e institucioneve vendore.

Ky tregues evidenton pjesëmarrjen e grave dhe të rejave në pozicione menaxheriale dhe profesionale brenda strukturave të bashkisë. Ai shërben për të monitoruar aksesin e barabartë të grave dhe të rejave në rolet vendimmarrëse në administratën vendore.

Njësia Matëse: Përqindje

Disagregim: Nuk ka

Formula: $GJ02 = (GJ02.2 / GJ02.1) * 100$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **GJ02.1** Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)
- **GJ02.2** Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)

GJ02.1 NUMRI I POZICIONEVE DREJTUESE TË NDRYSHME (TË LARTË, TË MESME, TË ULËT)

Përshkrimi i të dhënës: Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese të ndryshme të lartë, të mesme, të ulët: drejtorë/drejtor kabineti, sekretarë/sekretar i përgjithshëm, drejtorë/drejtor drejtorie, përgjegjëse/përgjegjës sektori, etj.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashki

Metoda e mbledhjes: Nxirret nga dosjet e personelit

Metoda e verifikimit: Kontroll i dokumentacionit të burimeve njerëzore

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

GJ02.2 NUMRI I GRAVE NË POZICIONE DREJTUESE TË NDRYSHME (TË LARTË, TË MESME, TË ULËT)

Përshkrimi i të dhënës: Numri i grave dhe të rejave në pozicionet: drejtorë kabineti, sekretarë e përgjithshme, drejtorë drejtorie, shefe/përgjegjëse sektori, etj.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashki

Metoda e mbledhjes: Nxirret nga dosjet e personelit

Metoda e verifikimit: Kontroll i dokumentacionit të burimeve njerëzore

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV.

TREGUESI GJ03 - PLAN VENDOR VEPRIMI PËR BARAZINË GJINORE

Rezultati i synuar: Rritja e institucionalizimit të barazisë gjinore në nivel vendor përmes planeve të dedikuara.

Ky tregues mat nëse bashkia ka miratuar dhe ka zbatuar një plan veprimi për të mundësuar përparimin drejt barazisë gjinore dhe trajtimin e barabartë të banoreve/banorëve të saj në përputhje me nevojat e ndryshme të tyre.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Disagregimi: Nuk ka

Formula: Nëse: (Vendimi i Këshillit Bashkiak ekziston dhe është publikuar në faqen zyrtare, ekziston konfirmimi i Institucionit të Prefektit dhe procesverbal i VKB-së nënshkruar nga 3 anëtare/anëtarë) → GJ03 = “Plan i miratuar në vitin e raportimit”. Ndryshe nëse: (Dokumentet e zbatimit si plani i masave, raporti i zbatimit dhe kostimi janë të disponueshme) → GJ03 = “Plan në zbatim (miratuar më herët)”. Përndryshe: → GJ03 = “Nuk ka plan”.

Përfshirja në GBP: Ky tregues është gjithashtu pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë.

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- GJ03.1 Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore i miratuar
- GJ03.2 Periudha e Miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore
- GJ03.3 Periudha e vlefshmërisë së Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore

GJ03.1 PLAN VENDOR VEPRIMI PËR BARAZINË GJINORE I MIRATUAR

Përshkrimi i të dhënës: E dhëna pasqyron nëse bashkia ka hartuar sipas një procesi të standardizuar dhe metodologjie gjithëpërfshirëse dhe miratuar një Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo).

Burimi: Njësia përgjegjëse në bashki.

Metoda e mbledhjes: Plan Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore është miratuar me vendim të KB, është publikuar në faqen e internetit të bashkisë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit dhe ka procesverbal të mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi, konsiderohet “Po” dhe në të kundërt “Jo”.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, linku i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse, vendimi i Institucionit të Prefektit që konfirmon VKB, procesverbali i nënshkruar nga tre anëtare/anëtarë të Këshillit Bashkiak me rezultatet e votimit për vendimin.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

GJ03.2 PERIUDHA E MIRATIMIT TË PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE

Përshkrimi i të dhënës: E dhëna pasqyron nëse bashkia reflekton periudhën e miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, i cili mund të jetë para vitit të raportimit, gjatë vitit të raportimit ose përgjatë vitit 2025.

Njësia Matëse: Muaj/Vit

Burimi: Njësia përgjegjëse në bashki

Metoda e mbledhjes: Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore është miratuar me vendim të KB, është publikuar në faqen e internetit të bashkisë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit dhe ka procesverbal të mbledhjes së Këshillit Bashkiak.

Metoda e verifikimit : Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin me numër vendimi, datë dhe vit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës

GJ03.3 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË PLANIT VENDOR PËR VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE

Përshkrimi i të dhënës: Bashkia reflekton periudhën e vlefshmërisë të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, i cili mund të jetë disa vjeçar.

Njësia Matëse: Numër (muaj nga muaji i raportimit)

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Kontroll dokumentacioni dhe statusi i zbatimit të planit

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, linku i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi. Buxhet dhe Plan Zbatimi nëse plani është aprovuar përpara vitit të raportimit. Konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV.

TREGUESI GJ04 – PËRQINDJA E BUXHETIT VENDOR TË ALOKUAR PËR NISMA QË MBËSHTESIN BARAZINË GJINORE NË SECILIN PROGRAM BUXHETOR VENDOR

Treguesi GJ04 nuk do të raportohen nga bashkitë, pasi do të sigurohet nga Ministria e Financave.

FUSHA: INTEGRIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, përfshirë pushtetin vendor. Bashkitë luajnë një rol kritik në afërsimin me acquis communautaire dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve.

Në këtë kuptim, bashkive u rekomandohet të:

- Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;
- Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale;
- Fuqizojnë rolin e komuniteteve në procesin e integritit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të besimit publik.

Në kuadër të integritit, bashkitë inkurajohen të vendosin marrëveshje ndërbashkiake dhe ndërkombëtare për shkëmbim praktikash, si dhe të krijojnë struktura të dedikuara (zyra integriti, koordinatorë të BE-së, njësi projekti) që ndihmojnë në adresimin e prioritetëve të agjendës evropiane.

Treguesit e kësaj fushe përfshijnë:

- Ekzistencën e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak për integritin evropian;
- Aplikimin dhe fitimin e projekteve me fonde IPA dhe të tjera BE;
- Akzistencën e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Plane dhe struktura për adresimin e diasporës dhe migracionit;
- Integritin e politikave të BE-së në dokumentet vendore të planifikimit strategjik.

Baza ligjore dhe strategjike përfshin:

- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Strategjia Kombëtare për Integritin Evropian dhe Plani Kombëtar për Integritin Evropian (PKIE);
- Udhëzuesit teknikë të Ministrisë së Integritit/MEPJ dhe AMVV;
- Strategjia e decentralizimit dhe dokumentet sektorale që kërkojnë përputhje me direktivat e BE-së.

Integriti evropian është gjithashtu një fushë ndërsektorale që lidhet me transparencën, digjitalizimin, zhvillimin e qëndrueshëm dhe forcimin e shtetit të së drejtës – për këtë arsye kërkon një qasje të koordinuar dhe kapacitet të qëndrueshëm brenda bashkive.

TREGUESI I01 - NUMRI I MARRËVESHJEVE NDËRBASHKIAKE TË NËNSHKRUARA NGA SECILA BASHKI

Rezultati i synuar: Rritja e bashkëpunimit ndërbashkiak për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe për të përmbushur standardet e BE-së.

Ky tregues vlerëson numrin e marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga bashkia për ofrimin e përbashkët të shërbimeve ose për bashkëpunim në fusha të caktuara me bashki të tjera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Njësia Matëse: Numër

Disagregimi: Nuk ka

Formula: I01= I01.1

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **I01.1 Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara**

I01.1 NUMRI I MARRËVESHJEVE NDËRBASHKIAKE TË NËNSHKRUARA

Përshkrimi i të dhënës: Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga bashkia për ofrimin e përbashkët të shërbimeve ose për bashkëpunim në fusha të caktuara.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Burimi: Njësia e Integritimit Evropian në bashki / Njësia e performancës

Metoda e mbledhjes: Evidentim nga regjistrat zyrtarë të marrëveshjeve

Metoda e verifikimit: Verifikim me dokumentacionin e marrëveshjeve

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV.

TREGUESI I02 - NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE TË PERFORMANCËS NË BASHKI

Rezultati i synuar: Përmirësimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjive dhe projekteve në kontekstin e integritimit evropian.

Ky tregues mat ekzistencën e strukturave të performancës në bashki si dhe pranë njësisë së integritimit evropian.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Disagregimi: Nuk ka

Formula: Treguesi konsiderohet “Po” vetëm nëse **një nga** të dhënat (I02.1 ose I02.2) rezultojnë “Po” në të kundërt “Jo”.

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **I02.1 – Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë**
- **I02.2 Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integritimit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së**

I02.1 STRUKTURA E PERFORMANCËS E NGRITUR NË ORGANIZIMIN FUNKSIONAL TË BASHKISË

Përshkrimi i të dhënës: Të dhënat tregojnë nëse, bashkia ka përfshirë funksionin e ndjekjes së performancës në organizimin e saj funksional. Kjo mund të realizohet përmes krijimit të një strukture të veçantë ose përmes delegimit të funksioneve përkatëse brenda një njësie ekzistuese (p.sh. integrimi evropian, zhvillimi strategjik, etj.). Dokumentet mbështetëse përfshijnë: rregulloren e brendshme administrative, përshkrimet e detyrave të njësive ose punonjësve përgjegjës, dhe çdo akt tjetër zyrtar që dokumenton rolin funksional të strukturës.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Burimi: Drejtoria e burimeve njerëzore / Sekretari i përgjithshëm

Metoda e mbledhjes: Raportim nga drejtoria e burimeve njerëzore sipas strukturave të ngritura

Metoda e verifikimit: Kontroll i i dokumentacionit mbështetës (rregullore të brendshme, përshkrime pune, vendime të brendshme)

Institucioni përgjegjes për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

I02.2 STRUKTURA E PERFORMANCËS E NGRITUR PRANË DREJTORISË SË INTEGRIMIT EVROPIAN SIPAS MANUALEVE ORIENTUESE TË AMVV-SË

Përshkrimi i të dhënës: Të dhënat tregojnë nëse, pranë njësisë së integritimit evropian në bashki, janë ngritur struktura të performancës në përputhje me manualët orientuese të AMVV.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Burimi: Njësia e Integritimit Evropian në bashki / Njësia e performancës

Metoda e mbledhjes: Raportim nga njësia sipas strukturave të ngritura

Metoda e verifikimit: Kontroll i dokumentacionit të strukturës dhe raporteve përkatëse

Institucioni përgjegjes për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

TREGUESI I03 - PROJEKTE TË FITUARA KUNDREJT TË APLIKUARA NGA BASHKIMI EVROPIAN (PERIUDHA 2-VJEÇARE 2023-2024)

Rezultati i synuar: Nxjtja e angazhimit proaktiv të bashkive në aksesimin e fondeve të Bashkimit Evropian dhe përmirësimi i planifikimit të projekteve.

Ky tregues shpreh shkallën e suksesit të aplikimeve të bashkive duke matur numrin e projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë vitit, përkundëjt numrit të projekteve të BE të miratuara për financim për bashkinë gjatë periudhës 2023-2024.

Njësia Matëse: Numër

Disagregimi: Nuk ka

Formula: $I03 = (I03.2 / I03.1)$

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- I03.1 Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës 2023-2024
- I03.2 Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës 2023-2024

I03.1 NUMRI I PROJEKTEVE TË BE QË BASHKIA KA APLIKUAR GJATË PERIUDHËS 2023-2024

Përshkrimi i të dhënës: Numri i aplikimeve për projekte të BE (IPA, ADRION, etj.) dorëzuar nga bashkia gjatë periudhës 2023-2024.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Njësia e Integrimit.

Metoda e mbledhjes: Lista e aplikimeve dhe dokumentet e dorëzuara

Metoda e verifikimit: Verifikim me kopjet e aplikimeve

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

I03.2 NUMRI I PROJEKTEVE TË BE TË FITUARA GJATË PERIUDHËS 2023-2024

Përshkrimi i të dhënës: Numri i projekteve të BE të miratuara për financim për bashkinë gjatë periudhës 2023-2024.

Njësia Matëse: Numër

Burimi: Drejtoria e Projekteve / Integrimit

Metoda e mbledhjes: Lista e njoftimeve për projekte të fituara

Metoda e verifikimit: Verifikim i dokumentacionit të kontratave të miratuara.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

TREGUESI I04 - PLANET E MIGRACIONIT DHE DIASPORËS

Rezultati i synuar: Bashkia arrin të krijojë qëndrueshmëri për kapacitet njerëzore, për të punuar e jetuar në territorin e bashkisë.

Ky tregues vlerëson nëse bashkia ka miratuar dhe ka zbatuar një plan të migracionit dhe diasporës për të adresuar “largimin e trurit” dhe migracionin e brendshëm.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Disagregimi: Nuk ka

Formula: I04 = Nëse: (Vendimi i Këshillit Bashkiak ekziston dhe është publikuar në faqen zyrtare, ekziston konfirmimi i Institucionit të Prefektit dhe procesverbal i VKB-së nënshkruar nga 3 anëtarë) → I04= “Plan i miratuar në vitin e raportimit”. Ndryshe nëse: (Dokumentet e zbatimit si plani i masave, raporti i zbatimit dhe buxheti janë të disponueshme) → I04 = “Plan në zbatim (miratuar më herët)”. Përndryshe: → I04 = “Nuk ka plan”.

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **I04.1 Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës i miratuar**
- **I04.2 Periudha e Miratimit të Planit të Migracionit dhe Diasporës**
- **I04.3 Periudha e vlefshmërisë së Planit të Migracionit dhe Diasporës**

I04.1 PLANI VENDOR I MIGRACIONIT DHE DIASPORËS I MIRATUAR

Përshkrimi i të dhënës: E dhëna pasqyron nëse bashkia ka hartuar dhe miratuar një Plan të Migracionit dhe Diasporës.

Njësia Matëse: Cilësore Po/Jo

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki.

Metoda e mbledhjes: Nëse Plani i Migracionit dhe Diasporës është miratuar me vendim të KB-së, është publikuar në faqe të internetit të bashkisë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit dhe ka procesverbal të mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi, konsiderohet “Po” ose në të kundërt “Jo”.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë, link-u i publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse, vendimi i Institucioni i Prefektit që konfirmon VKB, procesverbali i nënshkruar nga tre anëtarë të Këshillit Bashkiak me rezultatet e votimit për vendimin.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

I04.2 PERIUDHA E MIRATIMIT TË PLANIT TË MIGRACIONIT DHE DIASPORËS

Përshkrimi i të dhënës: E dhëna pasqyron nëse bashkia është duke zbatuar një Plan të Migracionit dhe Diasporës, para vitit të raportimit, gjatë vitit të raportimit dhe përgjatë vitit 2025.

Njësia Matëse: Muaj / Vit.

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organigramës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Kontrollohet nëse Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës është miratuar dhe përcaktohet muaji dhe viti i miratimit.

Metoda e verifikimit: Kontrollohet Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës për periudhën e miratimit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: AMVV / Njësia e Performancës.

I04.3 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË PLANIT TË MIGRACIONIT DHE DIASPORËS

Përshkrimi i të dhënës: Reflekton periudhën e vlefshmërisë së Planit të Migracionit dhe Diasporës, i cili mund të jetë disa vjeçar.

Njësia Matëse: Numër (muaj nga muaji i raportimit).

Burimi: Njësia përgjegjëse për shërbimin sipas organikës së bashkisë.

Metoda e mbledhjes: Kontroll dokumentacioni dhe i vlefshmërisë së planit.

Metoda e verifikimit: Vendimi i Këshillit Bashkiak që miraton planin, me numër vendimi dhe datë. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi. Buxhet dhe Plan Zbatimi nëse plani është aprovuar përpara vitit të raportimit. Konfirmimi i VKB nga Institucioni i Prefektit.

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

TREGUESI I05 - KOMISIONET E INTEGRIMIT EVROPIAN PRANË KËSHILLAVE BASHKIAKË

Rezultati i synuar: Forcimi i rolit mbikëqyrës dhe politik të këshillave bashkiakë në procesin e integrimit evropian dhe garantimi i koordinimit institucional në nivel vendor.

Ky tregues synon që Komisionet e Integrimit Evropian të jenë të ngritura dhe funksionale pranë këshillave bashkiakë për të garantuar ndjekjen e çështjeve që lidhen me procesin e integrimit dhe për të bashkërenduar veprimet në nivel vendor.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Disagregimi: Nuk ka

Formula: “Po” nëse Komisioni i Integritetit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë është ngritur dhe funksionon pranë Këshillit Bashkiak, në të kundërt “Jo”.

Të dhënat dhe mënyra e gjenerimit:

- **I05.1 Komisionet e Integritetit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë**

I05.1 KOMISIONET E INTEGRIMIT EVROPIAN PRANË KËSHILLAVE BASHKIAKË

Përshkrimi i të dhënës: Të dhënat tregojnë nëse gjatë vitit të raportimit, janë ngritur Komisionet e Integritetit Evropian.

Njësia Matëse: Cilësore (Po/Jo)

Burimi: Sekretaria e Këshillit Bashkiak

Metoda e mbledhjes: Vendimi për ngritjen e komisionit i miratuar nga Këshilli Bashkiak, raportet e Komisionit të Këshillit Bashkiak

Metoda e verifikimit: Verifikimi i dokumentacionit të mbledhjeve të KB (procesverbale, vendime, raporte vjetore).

Institucioni përgjegjës për verifikimin: Njësia e Performancës / AMVV

KATEGORIA: MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Kjo kategori ndahet në tri fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: **të ardhurat, shpenzimet dhe buxhetimi**. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizimin e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Treguesit që përfshihen në këtë kategori janë renditur më poshtë. Të dhënat dhe treguesit e Menaxhimit Financiar do të sigurohen nga Ministria e Financës.

FUSHA: TË ARDHURAT

Kjo fushë vlerëson kapacitetin e bashkisë për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme dhe diversifikuara përmes burimeve të veta dhe atyre të transferuara. Analiza e të ardhurave kontribuon në kuptimin e varësisë nga transfertat qendrore dhe fuqisë fiskale lokale. E drejta e njësive të vetëqeverisjes vendore për të

mbledhur të ardhura buron nga **neni 11 i Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**, i cili përcakton burimet e të ardhurave që administrohen nga bashkitë. Pesë treguesit e SMP-së janë renditur më poshtë.

F01. TË ARDHURAT E VETA PËR FRYMË NË LEKË

F02. TË ARDHURAT E VETA PËRKUNDREJT TRANSFERTAVE

F03. RAPORTI I TË ARDHURAVE TË VETA NDAJ BUXHETIT

F04. SHKALLA E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE

F05. TË ARDHURAT NGA TAKSA E PASURISË NË RAPORT ME TË ARDHURAT VENDORE

Përfshirja në GBP: Ky tregues është gjithashtu pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë.

FUSHA: BUXHETI

Fusha e buxhetit fokusohet në procesin e hartimit, miratimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor bashkiak, si dhe përputhshmërinë me ciklin buxhetor. Procesi i planifikimit dhe miratimit të buxhetit lokal rregullohet nga neni 21-25 i Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe nga udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave. Dy treguesit e kësaj fushe janë listuar më poshtë.

F06. BUXHETI PËR FRYMË (NË LEKË)

F07. SHKALLA E EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT: FAKT PËRKUNDREJT PLAN

Përfshirja në GBP: Ky tregues është gjithashtu pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë.

FUSHA: SHPENZIME

Kjo fushë analizon strukturën dhe efikasitetin e shpenzimeve publike të bashkive për të përmbushur funksionet e tyre ligjore. Ajo vlerëson nëse fondet shpenzohen në mënyrë të efektshme dhe transparente. Bashkitë janë përgjegjëse për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve publike vendore, në përputhje me **nenin 12 dhe 13 të Ligjit nr. 68/2017** dhe aktet nënligjore përkatëse. Pesë treguesit e kësaj fushe janë listuar më poshtë.

F08. INVESTIME PËR FRYMË (NË LEKË)

F09. PESHA E INVESTIMEVE NË BUXHET

F10. PESHA E DETYRIMEVE FINANCIARE TË PAPAGUARA NDAJ TË TRETËVE (%)

Përfshirja në GBP: Ky tregues është gjithashtu pjesë e kriterëve të vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë.

F11. PESHA E PERSONELIT NË BUXHET

F12. PESHA E SHPENZIMEVE OPERACIONALE NË BUXHET

Shtojca 1: Lista e miratuar e treguesve të Sistemit të Matjes së Performancës 2025 nga Grupi Ndërinstitucional i Punës

Nr.	Treguesit	Statusi i treguesit
KATEGORIA: SHËRBIME		
ARSIMI PARAUNIVERSITAR		
1	Shkalla e regjistrimit në çerdhe	I pandryshuar
2	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private	I pandryshuar
3	Numri i infrastrukurës arsimore parauniversitare sipas nivelit arsimor	Tregues i ri
4	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike dhe private	I pandryshuar
5	Plan Vendor të Arsimit Parauniversitar	Tregues i ri nga GBP
UJITJA DHE KULLIMI		
6	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	I përmirësuar
7	Përqindja e kanaleve funksionale të ujitjes dhe kullimit	Tregues i ri
PYJE DHE KULLOTA		
8	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	I pandryshuar
9	Punonjës për 1'000 hektarë	I pandryshuar
MBROJTJA NGA ZJARRI		
10	Zjarrëfikës për 1'500 banorë	I pandryshuar
11	Automjete zjarrëfikëse për 10'000 banorë	I pandryshuar
MENAXHIMI I MBETJEVE		
12	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	I përmirësuar
13	Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	I pandryshuar
14	Mbetjet e gjeneruara si kg/banorë	I pandryshuar
15	Kosto për ton/lekë	I pandryshuar
16	Plan Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve	Tregues i ri nga GBP
MBROJTJA SOCIALE		
17	Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	I pandryshuar
18	Shkalla e miratimit të strehimit social	I pandryshuar
19	Përqindja e rasteve të referuara nga Mekanizmi i Referimit për Dhunën	Tregues i ri
20	Përqindja e personave me aftësi të kufizuara, të referuar nga Komisionet Bio-Psiko-Sociale, që marrin mbështetje me shërbime sociale të integruara	Tregues i ri
21	Numri i qendrave sociale komunitare të licencuara për 10'000 banorë	I pandryshuar
22	Plan Vendor Social	Tregues i ri nga GBP

KATEGORIA: MIRËQEVERISJA		
BURIMET NJERËZORE		
23	Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë	I pandryshuar
24	Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar	I pandryshuar
25	Punonjës për 1'000 banorë	I pandryshuar
TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE		
26	Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak	I pandryshuar
27	Publikimi i Planit Buxhetor Afatmesëm PBA 2024–2026	Tregues i ri
28	Publikimi i Paketës Fiskale 2024	Tregues i ri
29	Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	Tregues i ri
30	Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Tregues i ri
31	Plan Vendor i Integritetit	Tregues i ri nga GBP
INTEGRIMI EVROPIAN		
32	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki	Tregues i ri
33	Strukturat e Performancës referuar Manualeve Orientuese të AMVV	Tregues i ri
34	Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga Bashkimi Evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024)	Tregues i ri
35	Planet e Migracionit dhe Diasporës	Tregues i ri
36	Komisionet e Integritetit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	Tregues i ri
BARAZIA GJINORE		
37	Përqindja e grave në pozicione: kryetar, zëvendëskryetar, këshilla bashkiakë dhe administratorë	I sugjeruar të detajohet
38	Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	I sugjeruar të detajohet
39	Përqindja e buxhetit vendor të alokuar për nisma që mbështesin barazinë gjinore në secilin program buxhetor vendor	Tregues i ri
40	Plan Veprimi i Barazisë Gjinore	Tregues i ri nga GBP
KATEGORIA: MENAXHIMI FINANCIAR		
TË ARDHURA		
41	Të ardhurat e veta për frymë në lekë	I pandryshuar
42	Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	I pandryshuar
43	Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	I pandryshuar
44	Shkalla e përdorimit të të ardhurave	I pandryshuar
45	Të ardhurat nga taksa e pasurisë në raport me të ardhurat vendore	I pandryshuar
BUXHETI		
46	Buxheti për frymë (në lekë)	I pandryshuar
47	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit: fakt përkundrejt plan	I pandryshuar

SHPENZIME		
48	Investime për frymë (në lekë)	I pandryshuar
49	Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve (%)	I pandryshuar
50	Pesha e investimeve në buxhet	I pandryshuar
51	Pesha e personelit në buxhet	I pandryshuar
52	Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	I pandryshuar